

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

PKR. Nr. 1046/13

3 shkurt 2014

Gjykata Themelore e Prishtinës, e përbërë nga kryetari i trupit gjykues i EULEX-it, Malcolm Simmons, në lëndën penalë kundër të pandehurve:

Emri **N**
Mbiemri **V**
Emri i babait
Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Vendndodhja

E akuzuar me këto akuza:

- 1. Krim i organizuar**, në shkelje të nenit 274 (1), (3) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);
- 2. Pastrim i parave**, në shkelje të nenit 32 (2) (2.1), (2.4) dhe (2.5), Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010 (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);
- 3. Vjedhje e rëndë**, në shkelje të neneve 252 (1) dhe 253 (2.1) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 327 i KPRK-së së vitit 2013);
- 4. Mashtrim**, në shkelje të nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 335 i KPRK-së së vitit 2013);
- 5. Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
- 6. Shpërdorim**, në shkelje të nenit 257 (1), (3) dhe (6) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 330 i KPRK-së së vitit 2013);
- 7. Keqpërdorim i besimit**, në shkelje të nenit 269 të KPK-së së vitit 2003 (Neni 342 i KPRK-së së vitit 2013);

8. Falsifikim i dokumenteve, në shkelje të nenit 332 (1) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 398 (1) i KPRK-së së vitit 2013);

9. Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve, në shkelje të nenit 333 (3) dhe (5) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 399 (1) (1.3) dhe (1.5) i KPRK-së së vitit 2013).

në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 23 të KPK-së të vitit 2003 (Neni 31 i KPK-së së vitit 2013)

Emri F

Mbiemri B

Emri i babait

Datëlindja

Vendlindja

Gjinia

Adresa

Kombësia

Nënshtetësia

Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

1. Krim i organizuar, në shkelje të nenit 274 (1), (3) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500,000 euro dhe me burgim nga shtatë deri në njëzet vjet (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);

2. Pastrim i parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010 (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);

3. Pranim i mallrave të vjedhura, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);

4. Shmangie nga tatimi, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1) dhe (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 23 të KPK-së së vitit 2003 (Neni 31 i KPK-së 2013)

Emri B

Mbiemri B

Emri i babait

Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

1. **Krim i organizuar**, në shkelje të nenit 274 (1), (2), (4) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);
2. **Pastrim i parave**, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010, veprë e dënueshme me gjobë ose burgim deri në dhjetë vjet (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);
3. **Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);

Emri **E**
Mbiemri **D**
Emri i babait
Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

1. **Krim i organizuar**, në shkelje të nenit 274 (1), (2), (4) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);
2. **Pastrim i parave**, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010 (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);
3. **Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);

4. Shmangie nga tatimi, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1) dhe (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

Emri I
Mbiemri F
Emri i babait
Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

- 1. Krim i organizuar**, në shkelje të nenit 274 (1), (2), (4) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);
- 2. Pastrim i parave**, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010 (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);
- 3. Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);
- 4. Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

Emri N
Mbiemri Th
Emri i babait
Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Numri i letërnjoftimit:
Vendndodhja:

I akuzuar me këto akuza:

1. **Krim i organizuar**, në shkelje të nenit 274 (1), (2), (4) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPRK-së së vitit 2013);
2. **Pastrim i parave**, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010 (Neni 308 i KPRK-së së vitit 2013);
3. **Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);
4. **Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

Emri J
 Mbiemri B
 Emri i babait
 Datëlindja
 Vendlindja
 Gjinia
 Adresa
 Kombësia
 Nënshtetësia
 Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

1. **Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);
2. **Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

Emri S
 Mbiemri Sh
 Emri i babait
 Datëlindja
 Vendlindja
 Gjinia
 Adresa
 Kombësia
 Nënshtetësia
 Vendndodhja

I akuzuar me këto akuza:

1. **Pranim i mallrave të vjedhura**, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së (Neni 345 i KPRK-së);
2. **Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (2) (2.1) dhe (2.5), dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

Emri H
Mbiemri Sh
Emri i babait
Datëlindja
Vendlindja
Gjinia
Adresa
Kombësia
Nënshtetësia
Vendndodhja

I akuzuar me këtë akuzë:

1. **Shmangie nga tatimi**, në shkelje të nenit 63 (1) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat;

PAS mbajtjes së shqyrtimit fillestar më 21 nëntor 2013;

DUKE VEPRUAR lidhur me kërkesat e mbrojtësve për të hedhur poshtë Aktakuzën, kryetari i trupit gjykues, në bazë të neneve 249 dhe 250(3) të KPPK-së, shqipton këtë:

A K T V E N D I M
LIDHUR ME KËRKESAT PËR HEDHJEN POSHTË TË AKTAKUZËS
DHE KUNDËRSHTIMET NDAJ PROVAVE

- I. **Kërkesa e mbrojtësve të të pandehurës N.V., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuzat 3, 6, 7, 8 dhe 9 të Aktakuzës në lidhje me N.V., hidhen**

poshtë dhe procedura në lidhje me këto akuza pushohet. Kërkesa e mbrojtësve në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.

- II. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit F.B., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuza 3 e Aktakuzës në lidhje me F.B., hidhet poshtë dhe procedura në lidhje me këtë akuzë pushohet. Kërkesa e mbrojtësit në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.
- III. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit B.B., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuza 3 e Aktakuzës në lidhje me B.B., hidhet poshtë dhe procedura në lidhje me këtë akuzë pushohet. Kërkesa e mbrojtësit në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.
- IV. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit E.D., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuza 3 e Aktakuzës në lidhje me E.D., hidhet poshtë dhe procedura në lidhje me këtë akuzë pushohet. Kërkesa e mbrojtësit në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.
- V. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit I.F., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuza 3 e Aktakuzës në lidhje me I.F., hidhet poshtë dhe procedura në lidhje me këtë akuzë pushohet. Kërkesa e mbrojtësit në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.
- VI. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit N.Th., për hedhjen poshtë të Aktakuzës pranohet pjesërisht. Akuza 3 e Aktakuzës në lidhje me N.Th., hidhet poshtë dhe procedura në lidhje me këtë akuzë pushohet. Kërkesa e mbrojtësit në lidhje me akuzat e mbetura të Aktakuzës hidhet poshtë si e pabazuar.
- VII. Kërkesat e mbrojtësve të të pandehurve J.B, S.Sh., dhe H.Sh., për hedhjen poshtë të Aktakuzës hidhen poshtë si të pabazuara.
- VIII. Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit J.B., për t'i shpallur provat si të papranueshme hidhet poshtë si e pabazuar.

PËRMBAJTJA

I. Ecuria procedurale:	10
II. Kundërshtimet ndaj Aktakuzës:	10
A) E pandehura N.V.,	10
Akuza 4: Mashtrimi	11
Akuza 3: Vjedhja e rëndë	13
Akuza 2: Pastrimi i parave.....	15
Akuza 5: Shmangia nga tatimi.....	17
Akuza 6: Shpërdorimi	18
Akuza 7: Keqpërdorimi i besimit	20
Akuza 8: Falsifikimi i dokumenteve.....	21
Akuza 9: Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve	22
Akuza 1: Krimi i organizuar	23
B) I pandehuri F.B.,	25
Akuza 2: Pastrimi i parave	25
Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura	27
Akuza 4: Shmangia nga tatimi.....	28
Akuza 1: Krimi i organizuar	29
C) I pandehuri B.B.	31
Akuza 2: Pastrimi i parave	31
Akuza 1: Krimi i organizuar	34
D) I pandehuri E.D.	36
Akuza 2: Pastrimi i parave	36
Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura	38
Akuza 4: Shmangia nga tatimi.....	39
Akuza 1: Krimi i organizuar	41
E) I pandehuri I.F.	44
Akuza 2: Pastrimi i parave	45
Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura	46
Akuza 4: Shmangia nga tatimi.....	48
Akuza 1: Krimi i organizuar	49
F) I pandehuri N.Th.,	50
Akuza 2: Pastrimi i parave	51

Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura	53
Akuza 4: Shmangia nga tatimi.....	54
Akuza 1: Krimi i organizuar	55
G) I pandehuri J.B.....	57
Akuzë 1: Pranimi i mallrave të vjedhura	57
Akuza 2: Shmangia nga tatimi.....	59
H) I pandehuri S.Sh.....	61
Akuza 1: Pranimi i mallrave të vjedhura	61
Akuza 2: Shmangia nga tatimi.....	62
I) I pandehuri H.Sh.	64
Akuza 1: Shmangia nga tatimi.....	64
III. Kundërshtimet ndaj provave:.....	66
III. Përfundim:	67

A R S Y E T I M :

I. Ecuria procedurale:

1. Më 7 nëntor 2013 Prokurori i EULEX-it i Prokurorisë Themelore në Prishtinë paraqiti Aktakuzën PP 898-4/2012, me të cilët i akuzonte të pandehurit si më lart.
2. Më 21 nëntor 2013 u mbajt shqyrtimi fillestar. Më pas të gjithë mbrojtësit, në pajtim me datën e caktuar nga kryetari i trupit gjykues, paraqitën kërkesa për hedhjen poshtë të Aktakuzës. Vetëm një i pandehur ushtroi kërkesë për kundërshtimin e provave.

II. Kundërshtimet ndaj Aktakuzës:

A) E pandehura N.V.,

3. Aktakuza e ngarkon të pandehurën N.V., me nëntë (9) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Vjedhje e rëndë;

Akuza 4: Mashtrim;

Akuza 5: Shmangie nga tatimi;

Akuza 6: Shpërdorim;

Akuza 7: Keqpërdorim i besimit;

Akuza 8: Falsifikim i dokumenteve; dhe

Akuza 9: Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve.

4. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet e pandehura, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 4: Mashtrimi

Pretendimi i prokurorit

5. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të mashtrimit. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

“Në nëntor të vitit 2011 dhe më 6 dhjetor të vitit 2011, në Prishtinë, e pandehura N.V., siguroi disa autorizime me shkrim nga O., përmes postës elektronike, që siç ia paraqiti ajo O., kërkoheshin me qëllim të transportimit dhe lëvrimin në MPB të makinerive dhe pasaportave elektronike përmes doganave. Në veçanti, e pandehura N.V., e mashtroi O., se autorizimi me shkrim i datës 6 dhjetor 2011 kërkonte fjalët “të gjitha detyrimet financiare të OeSD-së në Kosovë do të procesohen nga përfaqësuesja jonë zyrtare”, dhe numrin e llogarisë bankare të saj në NLB, që ajo në mënyrë të rreme këmbënguli se ishte i nevojshëm për t’u marrë me të gjitha çështjet doganore dhe për pjesët e këmbimit për makineritë. Pastaj ajo mashtroi përfaqësuesit e MPB-së se ky autorizim i posaçëm me shkrim i jepte asaj autoritetin të merrte të gjitha paratë e faturave për O., si përfaqësuese vendore e tyre, që ishte krejtësisht i rremë. Më tej ajo, pa lejen e O., në mënyrë mashtruese ndryshoi rreth 10 fatura të O., që arrinin shumën e përgjithshme të **3,410,343.91 eurove** duke shtuar kompaninë e saj, C.E., dhe numrin e llogarisë bankare të kompanisë së saj në pjesën e poshtme të faturave. Ndërmjet nëntorit 2011 dhe shtatorit 2012, ajo me dashje ia fshehu O., bërjen e këtyre ndryshimeve, dhe e mashtroi O., duke e bërë të besonte se MPB nuk po i paguante faturat. Duke kryer këto akte mashtruese, ajo siguroi një përfitim pasuror në shumën e **1,420,255.13 eurove.**”

Kundërshtimi i mbrojtjes

6. Mbrojtja pretendon se meqenëse përshkrimi faktik i veprave penale në akuzat 1 deri në 9 është pothuajse i njëjtë, atëherë këto vepra penale duhet të bashkohen.

Gjetja e gjykatës

7. Gjykata vëren se nuk është kontestuar se shuma prej 1,420,255.13 eurosh u pagua nga Ministria e Punëve të Brendshme (këtëj e tutje “MPB”) në llogarinë bankare të C.E., e gjitha në pronësi dhe menaxhim të së pandehurës N.V. Më pas, kjo shumë të hollash u transferua në llogari bankare të ndryshme, që u përkisnin personave të caktuar juridikë dhe fizikë. Rezultati përfundimtar është se kompania O., nuk i mori të hollat që kishte të drejtë t’i merrte sipas kontratës me MPB-në.

8. Në këtë rast kontestohet nëse mjetet u transferuan fillimisht në llogarinë bankare të C.E., dhe pastaj në llogari bankare të ndryshme, me ose pa pëlqimin e O. Qëndrimi i prokurorit është se këto para u transferuan nga MPB në llogarinë bankare të C.E., dhe më pas në llogari bankare të ndryshme pa pëlqimin e pronarit të parave, konkretisht O., nga Austria. Nga ana tjetër, e pandehura N.V., pretendon se ajo ishte autorizuar me rregull nga O., për ta marrë fillimisht këtë shumë të hollash në llogarinë bankare të C.E., dhe më pas ajo ishte udhëzuar të transferonte shumën prej 1,420,255.13 eurosh në llogari bankare të ndryshme. Gjykata vëren se ekziston një autorizim që O., ia ka lëshuar C.E., dhe N.V. E pandehura mbështetet në këtë autorizim për të justifikuar pagimin e parave nga MPB tek O. Megjithatë, është e paqartë përse e pandehura nuk ia transferoi paratë O. Në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë tregues ose provë që të tregojë se transferimi i shumës së kontestuar nga C.E., në llogari bankare të tjera u bë me pëlqimin e O. Përfaqësuesit e O., deklaruan përpara prokurorit se e pandehura N.V., fillimisht mohoi që paratë nga MPB të ishin kredituar në llogarinë bankare të kompanisë së saj. Më pas e pandehura deklaroi se këto mjete iu paguan zyrtarëve të MPB-së si ryshfet.

9. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se e pandehura e ka kryer veprën penale të mashtrimit, në shkelje të nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së së vitit 2003.

Akuza 3: Vjedhja e rëndë

Pretendimi i prokurorit

10. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të vjedhjes së rëndë. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

“Nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, e pandehura N.V., me dijeni dhe në mënyrë të paligjshme mori **1,420,255.13 euro** që MPB kishte pasur për qëllim t’ia paguante OeSD-së për pasaportat elektronike dhe makineritë e marra nga MPB. Pastaj ajo, në bashkë-kryerje me F.B., dhe me pjesëmarrjen e të tjerëve në një grup të organizuar kriminal, i përvetësoi këto para për veten e saj dhe për të tjerë, duke u transferuar **669,000 euro** disa të ashtuquajturave “kompani”, pa dijeninë, lejen ose pëlqimin as të OeSD-së dhe as të MPB-së. Më tej ajo transferoi një shumë shtesë prej **342,825 eurosh** tek individë dhe biznese, për të mbuluar borxhet dhe shpenzimet personale të saj dhe të të pandehurit F.B., përfshirë një banesë për **77,000 euro** për të pandehurën N.V., **39,000 euro** për Kompaninë “Fimex” të F.B., dhe **20,000 euro** për Kompaninë F.O., të B.B. Më tej ajo tërhoqi **470,953.87 euro** në para të gatshme dhe shpenzoi **27,876.92 euro** për shpenzimet në pikën e shitjes për përdorim vetjak të saj.”

Kundërshtimi i mbrojtjes

11. Në parashtrësën e tyre të datës 17 dhjetor 2013, mbrojtësit e së pandehurës N.V., deklarojnë se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se kjo vepër penale u krye nga e pandehura.

“Në fakt, më 30.06.2010, ndërmjet Fimex, PMC dhe O., u lidh një kontratë, por më vonë me kërkesën e MPB-së se O., duhet të ketë përfaqësuesin e vet në Kosovë, dhe pastaj me miratim të O., N.V., regjistroi kompaninë C.E. për zbatimin e Kontratës si përfaqësuese vendore. Çështja se N.V., ishte përgjegjëse për pagesat e MPB-së për O., vërtetohet gjithashtu nga fakti se në

autorizim përcaktohet “të gjitha detyrimet financiare të O., në Kosovë do të vlerësohen nga përfaqësuesja jonë zyrtare (llogaria bankare nr. XXXXXXXXXXXXXXX, NLB Prishtinë)”. Në llogarinë bankare të treguar më lart u paguan 3,400,000.00 dhe më shumë se tre herë u transferuan mjete tek O., nga kompania C.E., dhe askush nuk u ankua apo bëri ndonjë vërejtje ndonjëherë. Ky fakt është më shumë se një tregues se N.V., e ka kryer çdo veprim në mënyrë të ligjshme dhe në pajtim me autorizimet. Përdorimi i vulës së O., në fatura dhe në emër të C.E., nuk ishte shmangie nga kompetencat e dhëna nga autorizimet, sepse ajo ishte në ngarkim të vulës dhe e autorizuar ta përdorte atë në lidhje me zbatimin e Kontratës për pasaportat. Kësisoj, duke ndryshuar faturat, ajo nuk vodhi, nuk mashtroi, ose nuk falsifikoi etj., sepse me shumën 1,420,255.13 euro që nuk iu transferua O., u paguan këto fatura: dogana, TVSH, disa pagesa për disa kompani në varësi të detyrimeve kontraktuale, madje edhe hua, si dhe pagesat për punën e saj të kryer si përfaqësuese e OeSD-së në lidhje me Kontratën ndërmjet O., dhe MPB-së, shumë që i takonte asaj dhe që u miratua në totalin 800,000 euro.”

12. Më tej, mbrojtja deklaron se:

“Sipas përshkrimeve faktike, nuk qëndron as vjedhja, si vepër penale, as vjedhja e rëndë, sepse në këtë rast nuk ka veprime të së akuzuarës që do të vërtetonin veprën penale të vjedhjes ose vjedhjes së rëndë, posaçërisht në situata të tilla kur kemi të bëjmë me veprën penale të vjedhjes së rëndë duhet të ekzistojnë një numër elementesh që e përshkruajnë këtë vepër penale dhe po kështu, pasi për këtë kërkohet forcë etj.”

Gjetja e gjykatës

13. Gjykata vëren se prokurori pretendon fakte pothuajse identike në Akuzat 3 dhe 4 dhe në të njëjtën kohë e akuzon të pandehurën me dy vepra penale të ndryshme – vjedhje e rëndë dhe mashtrim. Në këtë lëndë, akuzimi i së pandehurës me veprën penale të

mashttrimit dhe vjedhjes së rëndë për të njëjtat fakte të pretenduara, është i tepërt. Ndërsa vepra penale e vjedhjes së rëndë kryhet kur dikush merr “pasuri të tundshme të një personi tjetër me qëllimin që **në mënyrë të paligjshme ta përvetësojë** atë për veten e tij”, vepra penale e mashttrimit kryhet kur një person përvetëson fitim pasuror nga mashtrimi i një personi, me anë të përfaqësimit të rremë ose duke fshehur fakte. Mashtrimi ka si qëllim fshehjen e fakteve, ndërsa vjedhja jo. Hajdutët e dinë se nuk mund ta fshehin aktin e tyre, prandaj nuk bëjnë shumë përpjekje për ta fshehur atë, ndërsa mashtruesit bëjnë përpjekje shtesë për ta fshehur aktin. Të dy veprat penale janë pikësnyuar të mbrojnë pasurinë nga përvetësimi i kundërligjshëm. Vepra penale e mashttrimit është më specifike, sepse përvetësimi i kundërligjshëm bëhet përmes mjeteve të mashttrimit. Prandaj dispozita për veprën penale të mashttrimit është *lex specialis* kundrejt dispozitës për veprën penale të vjedhjes së rëndë, dhe zbatohet parimi *lex specialis derogat legi generalis*.

14. Prandaj gjykata vendosi ta hedhë poshtë Akuzën 3 të Aktakuzës në lidhje me të pandehurën N.V.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

15. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të vjedhjes së rëndë. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga 13 dhjetori 2011 deri më 30 gusht 2012, në Prishtinë, e pandehura N.V., në bashkë-kryerje me të pandehurin F.B., dhe të tjerë, transferoi rreth **669,000 euro para të vjedhura** tek disa “kompani”, që Velija nuk ia transferoi O. Këto transferta për “kompani” ishin me qëllimin e posaçëm të fshehjes ose maskimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, lëvrimit, lëvizjes ose pronësisë së parave të vjedhura. E pandehura N.V., në asnjë moment nuk pati leje ose autorizim nga O., për t’i marrë paratë nga MPB. Ajo gjithashtu me dijëni, në bashkë-kryerje me F.B., transferoi **342,825 euro para të vjedhura** tek persona*

dhe biznese, për të shlyer borxhet dhe shpenzimet e saj personale dhe të të pandehurit F.B., përfshirë një banesë për 77,000 euro për të pandehurën N.V., (që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje) dhe 39,000 euro për Kompaninë “Fimex” të F.B., dhe 20,000 euro për Kompaninë F.O., B.B.. Këto transferta të paligjshme dhe joligjore më tej nxitën vjedhjen e rëndë dhe krime të tjera themelore të kryera nga e pandehura N.V., dhe të tjerët.

Kundërshtimi i mbrojtjes

16. Në parashtresën e tyre të datës 17 dhjetor 2013, mbrojtësit e së pandehurës N.V., deklarojnë se:

“Pastrimi i parave, sipas Aktakuzës, ndërlidhet me veprën penale nën Akuzën 1 dhe ne konsiderojmë se pretendimi i prokurorit lidhur me këtë vepër penale nuk do të provohet.”

Gjetja e gjykatës

17. Gjykata vëren se shumica prej 669,000 eurosh e pretenduar se i është vjedhur O., u transferua në shumë llogari bankare të ndryshme të kompanive të ndryshme. N.V., deklaroi se ajo mori udhëzime nga zyrtarët e OeSD-së për ta transferuar këtë shumë të hollash tek këto kompani. Megjithatë, personat të cilët i morën paratë, si dhe përfaqësuesit e O., i përgënjeshtrojnë këto pretendime. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se transferimi i parave nga llogaria bankare e CE u bë me qëllimin e fshehjes dhe maskimit të natyrës së këtyre parave të pretenduara si të vjedhura.

18. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se N.V., kreu veprën penale të pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 paragrafi (2) nën-paragrafët (2.1) (2.4) dhe (2.5) të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të vitit 2010.

Akuza 5: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

19. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, N.V., në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme mori dhe nuk transferoi rreth **1,420,255.13 euro** të të ardhurave të paligjshme që i përkisnin OeSD-së dhe pastaj tërhoqi nga kjo shumë **470,953.87 euro** në para të gatshme dhe shpenzoi **27,876.92 euro** për shpenzimet POS. Ajo gjithashtu, në bashkë-kryerje me të pandehurin Fisnik Blakaj, në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme transferoi rreth **342,825 euro** për të mbuluar borxhet dhe shpenzimet personale të saj dhe të F.B., përfshirë një banesë për **77,000 euro** (që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje) për të pandehurën N.V., **39,000 euro** për Kompaninë "F." të F.B., dhe **20,000 euro** për Kompaninë F.O., të B.B. Më tej ajo, në bashkë-kryerje me F.B., dhe të tjerët, në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme transferoi **669,000 euro para të vjedhura** tek disa të ashtuquajtura "kompani", me qëllimin për të fshehur paratë. Ajo me dashje nuk veproi dhe nuk raportoi asgjë nga kjo shumë prej **1,420,255.13 eurosh** të të ardhurave të paligjshme pranë Administratës Tatimore të Kosovës (AT), as pagoi ndonjë tatim për këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se kompania CE e N.V., ka një detyrim prej **422,951.19 eurosh** për shmangie nga tatimi për vitet 2011-2012 dhe, krahas kësaj, një raport i përpiluar nga AT deklaroi se bazuar në pasqyrën bankare të saj në NLB, ajo nuk deklaroi **1,613,545.23 euro** si qarkullim për vitet 2011-2012.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

20. Mbrojtja pretendon se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se e pandehura e ka kryer këtë veprë penale.

Gjetja e gjykatës

21. Gjykata është e mendimit se ka dyshim të mirë-bazuar se e pandehura me dashje nuk raportoi tek autoritetet tatimore shumë prej **1,613,545.23 eurosh** si qarkullim për vitet 2011-2012. Kjo shumë e tejkalon shumë që akuza pretendon se u përvetësua nga e pandehura. Kjo mbështetet nga raporti i përgatitur nga AT. Qëllimi i së pandehurës mund të nxirret nga rrethanat e lëndës, sepse ajo është e mirë-arsimuar dhe ka qenë në biznes për një farë kohë.
22. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se e pandehura veprimi në shkelje të nenit 63(2), (2)(2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (2010) dhe në shkelje të nenit 44(1) të ATP-së.

Akuza 6: Shpërdorimi

Pretendimi i prokurorit

23. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të shpërdorimit. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*“Nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, ajo në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme mori dhe nuk transferoi rreth **1,420,255.13 euro** tek O., që ajo në mënyrë të paligjshme i mori nga MPB dhe që i ishin besuar asaj nga MPB për të paguar O. Më tej ajo i mori këto para me qëllimin për të siguruar një përfitim pasuror të paligjshëm për veten e saj, F.B., dhe të tjerët. Nga kjo shumë, ajo tërhoqi në para të gatshme **470,953.87 euro** dhe shpenzoi **27,876.92 euro** për shpenzimet pikën e shitjes dhe më tej ajo, në bashkë-kryerje me F.B., dhe pjesëmarrës të tjerë në një grup të organizuar kriminal, transferoi **669,000 euro** tek disa të ashtuquajtura “kompani”, për të fshehur paratë. Më tej ajo, në bashkë-kryerje me të pandehurin F.B., transferoi rreth **342,825 euro**, për të mbuluar borxhet dhe shpenzimet personale të tyre,*

përfshirë blerjen e një banese për 77,000 euro për N.V., 39,000 euro për Kompaninë "F." të F.B., dhe 20,000 euro për Kompaninë F.O., të B.B."

Kundërshtimi i mbrojtjes

24. Mbrojtja nuk ofroi ndonjë analizë të posaçme se mbi cilën bazë ajo kërkon rrëzimin e Aktakuzës në lidhje me këtë, përveç se deklaroi se nuk ka dyshim të mirë-bazuar për ta mbështetur Aktakuzën në përgjithësi.

Gjetja e gjykatës

25. Në këtë akuzë prokurori pretendon se MPB ia besoi paratë të pandehurës N.V., me qëllim që kjo e fundit t'ia paguante O. Ky pretendim nuk mbështetet nga ndonjë provë në shkresat e lëndës. Në shkresat e lëndës nuk ka prova që të sugjerojnë se MPB i caktoi ndonjë përgjegjësi të pandehurës për t'i bërë pagesa O. Madje ky pretendim është në kundërshtim me Akuzën 4 të Aktakuzës, që deklaron se e pandehura mashtrroi si O., ashtu dhe MPB-në, domethënë që O., mendonte se autorizimi mbulonte vetëm çështjet që kishin të bënin me doganat, ndërsa MPB mendonte se autorizimi mbulonte edhe pagesën e borxheve të pashlyera. Kësisoj, në bazë të fakteve të pretenduara nga prokurori, MPB u mashtrua për të menduar se pagesa e borxhit të pashlyer i ishte besuar CE– kompania e së pandehurës, ndërsa nga ana tjetër kjo "lënie në besim" nuk ishte e vërtetë, sepse autorizimi nuk e autorizonte CE dhe N.V., t'i merrte paratë. MPB nuk pati në asnjë moment diskrecionin që paratë që i përkisnin O., t'ia besonte kompanisë së pandehurës N.V.

26. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se kjo vepër penale është kryer dhe, për rrjedhojë, vendosi ta rrëzojë këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 7: Keqpërdorimi i besimit

Pretendimi i prokurorit

27. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të keqpërdorimit të besimit. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga shtatori 2011 deri në nëntor 2012, e pandehura N.V., në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme, si përfaqësuese vendore e OESD-së për zbatimin e kontratës për pasaportat elektronike dhe makineritë, datë 17 qershor 2011, nuk i transferoi OESD-së **1,420,255.13 eurot** që MPB ia kishte besuar asaj, bazuar në përfaqësimet e rreme që ajo i dha MPB-së. Më tej ajo kreu keqpërdorim të besimit dhe shpërdorim të autoritetit me O., duke keqpërdorur autorizimet me shkrim që i ishin dhënë asaj nga O., nën pretendime të rreme, me qëllim që ta bindte MPB-në të transferonte 1,420,255.13 euro në llogarinë bankare të saj në NLB. Pastaj ajo nuk ia dha O., të 1,420,255.13 eurot për të cilat O., nuk i dha asaj asnjëherë leje ose autoritet t'i posedonte. Këto veprime i shkaktuan dëm të madh si O., ashtu dhe MPB-së.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

28. Mbrojtja pretendon se, meqenëse përshkrimi faktik i veprave penale në akuzat nga 1 deri në 9 është pothuajse i njëjtë, atëherë këto vepra penale duhet të bashkohen.

Gjetja e gjykatës

29. Prokurori pretendon se e pandehura “nuk ia transferoi O., të **1,420,255.13 eurot që MPB ia kishte besuar asaj**”. Në shkresat e lëndës nuk ka prova për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se në ndonjë moment MPB i caktoi ndonjë përgjegjësi të pandehurës N.V. Personi i vetëm i cili kishte diskrecion t'i caktonte ndonjë përgjegjësi të pandehurës N.V., ishte kompania O. Megjithatë, prokurori pretendon se në fakt O.,

vërtet ia besoi pagesën e faturave të pandehurës, por kjo e fundit e mashtroi O., dhe MPB-në, me qëllim që të siguronte përfitim pasuror për veten dhe të tjerët.

30. Prandaj gjykata gjen se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se e pandehura e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të besimit, kësisoj vendosi ta rrëzojë këtë akuzë të Aktakuzës në lidhje me të pandehurën N.V.

Akuza 8: Falsifikimi i dokumenteve

Pretendimi i prokurorit

31. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

“Nga shtatori 2011 deri në nëntor 2012, N.V., në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme ndryshoi të paktën 10 fatura nga OESD, pa pasur autoritetin, lejen, dijeninë ose pëlqimin e OeSD-së, duke shtuar emrin e kompanisë së saj, C.E., numrin e llogarisë bankare të saj, TVSH-në dhe fjalë të tjera, duke përdorur ndërkohë vulën e rregullt të O., me çka krijoi dokumente të rreme q rezultoi në marrjen nga e pandehura të më se 3,000,000 eurove që i përkisnin O. Nga kjo shumë, ajo nuk i transferoi rreth O.,-së 1,420,255.13 euro.”

Gjetja e gjykatës

32. Në këtë lëndë ekziston kryerja e njëkohshme e veprave penale. Vepra penale e mashtrimit konsumon veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Faturat e pretenduara të falsifikuara janë pjesë e përfaqësimit të rremë, që është element i veprës penale të mashtrimit. Prandaj, akuzimi i së pandehurës me mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve në të njëjtën kohë në këtë lëndë, do të ishte i tepërt. Vepra penale e mashtrimit konsumon falsifikimin e dokumenteve.

33. Prandaj, gjykata vendos ta rrëzojë këtë akuzë të Aktakuzës në lidhje me të pandehurën N.V.

Akuza 9: Raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve

Pretendimi i prokurorit

34. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të rasteve të veçanta të falsifikimit të dokumenteve. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

“Nga shtatori 2011 deri në nëntor 2012, N.V., në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme lëshoi fatura të ndryshuara të O., duke përdorur vulën e rregullt të O., autorizimin e O., dhe ia paraqiti ato MPB-së. Kjo solli marrjen prej saj, përmes kompanisë së saj C.E., të më shumë se 3,000,000 eurove, pa autoritetin, lejen, dijeninë ose pëlqimin e O. Më pas ajo nuk i transferoi O., 1,420,255.13 euro të këtyre parave, siç u shpjegua më herët.”

Gjetja e gjykatës

35. Në këtë lëndë ekziston kryerja e njëkohshme e veprave penale. Vepra penale e mashtrimit konsumon veprën penale të rasteve të veçanta të falsifikimit të dokumenteve. Faturat e pretenduara të falsifikuara janë pjesë e përfaqësimit të rremë, që është element i veprës penale të mashtrimit. Prandaj, akuzimi i së pandehurës me mashtrim dhe raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve në të njëjtën kohë në këtë lëndë, do të ishte i tepërt. Vepra penale e mashtrimit konsumon akuzën lidhur me falsifikimin e pretenduar të dokumenteve (raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve).

36. Prandaj, gjykata vendos ta rrëzojë këtë akuzë të Aktakuzës në lidhje me të pandehurën N.V.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

37. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga e pandehura N.V., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*“Nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, e pandehura N.V., me dijeni nuk transferoi rreth **1,420,255.13 euro** që ajo në mënyrë të paligjshme i pranoi llogarinë bankare të saj në NLB nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), që duhej t’i ishin dërguar kompanisë O. Paratë që ajo i mori në mënyrë të paligjshme ishin pagesë për faturat e O., për pasaportat elektronike dhe makineritë që iu dërguan MPB-së. Më tej ajo tërhoqi rreth **470,953.87 euro para të vjedhura** në ATM dhe tërhoqi në para të gatshme, shpenzoi **27,876.92 euro** për shpenzimet në pikën e shitjes dhe në mënyrë të paligjshme transferoi, me ndihmën e bashkë-kryerësit F.B., dhe pjesëmarrësve të tjerë në grupin kriminal, rreth **669,000 euro para të vjedhura** tek disa të ashtuquajtura “kompani.” Po kështu, në bashkë-kryerje me të pandehurin F.B., ajo transferoi në mënyrë të paligjshme rreth **342,825 euro para të vjedhura** për të mbuluar borxhet dhe shpenzimet personale të saj dhe të F.B., përfshirë blerjen e një banese për **77,000 euro** për të pandehurën N.V., (që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje) dhe **39,000 euro** tek Kompania “F.” e të pandehurit F.B., dhe **20,000 euro** tek Kompania F.O., e B.B. Këto transferta të paligjshme dhe joligjore të bëra nga e pandehura N.V., në bashkë-kryerje me F.B., dhe me pjesëmarrjen e të tjerëve, kishin qëllimin e posaçëm të fshehjes së natyrës, burimit, vendndodhjes, lëvizjes ose pronësisë së parave të vjedhura dhe i siguruan asaj një përfitim ekonomik shumë të madh, të kundërligjshëm dhe të paligjshëm në kurriz të të dëmtuarve O., MPB dhe popullit të Kosovës.”*

Kundërshtimi i mbrojtjes

38. Mbrojtja deklaron se “nuk ka krim të organizuar në rast se struktura organizative e tij nuk ka mbështetje në ndonjë strukturë shtetërore ose partiake”. Më tej nuk ka analizë të kësaj deklarate, përveç paraqitjes së fakteve të analizës së lëndës në lidhje me pretendimet e prokurorit.

Gjetja e gjykatës

39. Gjykata gjen se ka dyshim të mirë-bazuar se e pandehura N.V., në bashkëpunim me F.B., me dijeni dhe në mënyrë të paligjshme, organizoi përmes kontaktit me përfaqësues të kompanive të ndryshme, konkretisht B.B., E.D., I.F., dhe N.Th., transferimin tek këto kompani të **669,000 eurove** të parave të vjedhura të përshkruara më lart, për të fshehur dhe maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen, lëvrimin, lëvizjen ose pronësinë e këtyre parave të supozuara të vjedhura. Kjo gjetje mbështetet nga deklaratat e të pandehurve dhe pasqyra bankare e kompanisë së të pandehurës N.V.

40. Ka dyshim të mirë-bazuar se të pandehurit e lart-përmendur formuan një grup të organizuar kriminal, që ishte i strukturuar dhe përbëhej nga më shumë se tre persona, që ekzistoi nga dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, me qëllim kryerjen e veprës penale të pastrimit të parave, konkretisht pastrimit të produkteve nga paratë e supozuara të përvetësuara në mënyrë të kundërligjshme, siç përshkruhet në Akuzën 4 të kësaj Aktakuze në lidhje me këtë të pandehur.

41. Të pandehurit dhanë shpjegime të ndryshme të ngjarjeve lidhur me arsyen se përse këto para u transferuan nga kompania C.E., në llogari bankare të ndryshme. Ky është tregues se qëllimi i grupit ishte të shpëlante produktet e krimit të pretenduar.

42. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e krimit të organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), i vitit 2003, është kryer nga kjo e pandehur.

B) I pandehuri F.B.,

43. Aktakuza e ngarkon të pandehurin F.B., me katër (4) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 4: Shmangie nga tatimi

44. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

45. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri F.B., duke kryer kështu veprën penale të pastrimit të parave. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga 13 dhjetori 2011 deri në gusht 2012, i pandehuri F.B., në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., dhe të tjerët, transferoi rreth **669,000 euro para të vjedhura** që e pandehura Velija i mori nga MPB dhe OESD tek disa "kompani", me qëllimin për të fshehur dhe maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen, lëvrimin, lëvizjen ose pronësinë e parave të vjedhura. I pandehuri F.B., në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., fitoi, posedoi, përdori dhe transferoi*

*një shumë shtesë prej rreth **342,825 eurosh para të vjedhura** tek individë dhe biznese, për të shlyer borxhet dhe shpenzimet personale të tyre, përfshirë blerjen nga N.V., të një banese për **77,000 euro** (që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje), transferoi **39,000 euro** tek Kompania F., e F.B., dhe **20,000 euro** tek Kompania F.O., e B.B. Përpjekjet e bashkërenduara të F.B., për t'i bërë të gjitha këto transferta të shumave të mëdha të parave e ndihmuan më tej të pandehurën N.V., t'u shmangej pasojave ligjore të veprimeve kriminale të saj dhe këto transferta të shumta qartazi nxitën veprimtarinë kriminale themelore.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

46. Në deklaratën e tij në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës, mbrojtësi pretendon se akuza është përshkruar në terma të përgjithshëm, pa deklarata konkrete se kush ishte koordinatori, numri i tyre dhe përse i akuzuari F.B., duhet trajtuar si koordinatori kryesor. Me fjalë të tjera, mbrojtja pretendon se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale.

Gjetja e gjykatës

47. Gjykata ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri F.B., e ka kryer veprën penale të pastrimit të parave. Analiza e gjykatës në lidhje me këtë paraqitet nën paragrafin 8 të këtij vendimi dhe nuk do të përsëritet këtu.

48. Më tej, ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri F.B., ishte bashkërendues ndërmjet të pandehurës N.V., dhe marrësve të parave, konkretisht B.B., E.D, N.Th., dhe I.F., dhe se arsyeja për këto transferta të shumëfishta ishte të maskohej dhe fshihej natyra e produkteve të krimit të pretenduar. Kjo gjetje e gjykatës bazohet në transaksionet dhe pasqyrat bankare të të pandehurve. Paratë që i përkisnin O., pretendohet se u siguruan me anë të mashtrimit nga e pandehura N.V., dhe më pas u transferuan në llogaritë bankare të të pandehurve të tjerë. Shumica e këtyre të pandehurve pretendojnë se i

morën këto mjete nga F.B. Megjithatë, N.V., u deklaroi përfaqësuesve të O.,-së se këto para iu paguan si ryshfet zyrtarëve të MPB-së.

49. Prandaj ka dyshimi të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të vitit 2010.

Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

50. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri F.B., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri F.B., pranoi **30,000 euro para të vjedhura** nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., më 14 mars 2012 dhe **4,000 euro** më 17 prill 2012. Më 22 dhjetor 2011 dhe 30 janar 2012, ai mori gjithashtu shumën shtesë prej **5,000 eurosh** nga paratë e vjedhura në llogarinë bankare të N.V., kinse për të paguar qiranë për zyrat e tyre. Më tej ai, në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., rregulloi transferimin e 669,000 eurove të parave të vjedhura të përshkruara më lart tek disa “kompani” dhe rregulloi transferimin e një shumë shtesë prej 342,825 eurosh tek individë privatë dhe biznese, për të shlyer borxhet dhe shpenzimet personale të tij dhe të N.V., përfshirë blerjen e një banese me çmimin e 77,000 eurove për të pandehurën N.V., dhe 20,000 euro për kompaninë F.O., të vëllait të tij. Fakti që F.B., e ndihmoi të pandehurën N.V., në shpërndarjen e parave të vjedhura demonstroi qartë se i pandehuri F.B., e dinte se paratë ishte të vjedhura dhe i pranoi ato për përfitimin personal të tij.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

51. Mbrojtja argumenton se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se kjo vepër penale është kryer.

Gjetja e gjykatës

52. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave është kryer nga i pandehuri, gjykata arrin në përfundimin se ka njëkohshmëri të veprave penale. Posaçërisht, vepra penale e pastrimit të parave konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Në këtë rast i pandehuri, nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me veprën penale të pastrimit të parave, që është vepër penale komplekse, dhe pranim të produkteve të një krimi (në këtë rast të parave të përvetësuar në mënyrë të paligjshme) është vetëm një komponent i veprës penale të pastrimit të parave, që konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura.

53. Prandaj, gjykata vendosi ta rrëzojë Aktakuzën në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 4: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

54. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri F.B., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

“I pandehuri F.B., pranoi 30,000 euro para të vjedhura nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., më 14 mars 2012 dhe 4,000 euro më 17 prill 2012. Ai mori gjithashtu shumën shtesë prej 5,000 eurosh nga paratë e vjedhura në llogarinë bankare të N.V., kinse për të paguar qiranë për zyrat e tyre. Më tej, në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., ai rregulloi transferimin e 669,000 eurove tek disa “kompani” dhe rregulloi transferimin e një shumë shtesë prej 342,825 eurosh tek individë privatë dhe biznese, për të mbuluar borxhet dhe shpenzimet personale të tij dhe të N.V., përfshirë blerjen e një banese që kushtoi 77,000 euro për të pandehurën Velija dhe 20,000 euro për kompaninë F.O., të vëllait të tij. I pandehuri F.B., me dashje nuk veproi dhe nuk raportoi asnjëherë prej këtyre të ardhurave të paligjshme tek Autoritetet e Administrimit

të Taksave (AT), as pagoi ndonjë tatim për këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT deklaroi se F., ka përgjegjësi ligjore për **35,168.46 euro** për shmangie nga tatimi në vitet 2010-2012 dhe F., pronarët e së cilës janë F.B., dhe N.V., ka përgjegjësi ligjore për **11,875.84 euro** për shmangie nga tatimi në vitin 2012.”

Kundërshtimi i mbrojtjes

55. Mbrojtja pretendon se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se kjo vepër penale është kryer.

Gjetja e gjykatës

56. Gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri F.B., me dashje nuk raportoi asnjërën prej të ardhurave të paligjshme të tij tek Autoritetet Tatimore. Kjo gjetje bazohet në raportin e AT-së për vitet 2010-2012, nga ku rezulton se për vitin 2012 është e papaguar shuma prej 11,875.84 eurosh.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

57. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri F.B., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*“Nga 13 dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, F.B., në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., dhe me pjesëmarrjen e të tjerëve, me dijeni dhe në mënyrë të paligjshme, organizoi përmes kontaktit me përfaqësues të të ashtuquajturave “kompani”, transferimin e **669,000 eurove** të parave të vjedhura të përshkruara më lart tek këto të ashtuquajtura “kompani”, për të fshehur dhe maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen, lëvrimin, lëvizjen ose pronësinë e parave të vjedhura. I pandehuri F.B., i njëjtte personalisht pronarët ose agjentët e autorizuar të këtyre “kompanive”, dhe organizoi transferimin e*

*parave të vjedhura në llogaritë bankare të “kompanive”. Gjithashtu, i pandehuri F.B., në bashkë-kryerje me të pandehurën N.V., organizoi transferimin e rreth **342,825 eurove para të vjedhura** tek individë dhe biznese, për të shlyer borxhet dhe shpenzimet personale të tyre, përfshirë një banesë për **77,000 euro** për të pandehurën N.V., **39,000 euro** tek Kompania “F.,” e F.B., dhe **20,000 euro** tek Kompania F.O., e B.B. Këto transferua parash, të shumta dhe në shuma të mëdha, të bashkërenduara nga të pandehurit F.B., N.V., dhe të tjerë, u bënë me qëllimin e posaçëm të “pastrimit”, fshehjes, maskimit ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes ose pronësisë së parave të vjedhura, dhe i siguruan atij, N.V., dhe të tjerëve një përfitim ekonomik të kundërligjshëm dhe të paligjshëm në shumën e përgjithshme 1,420,255.13 euro, në kurriz të të dëmtuarve O., MPB dhe popullit të Kosovës.”*

Kundërshtimi i mbrojtjes

58. Mbrojtja pretendon se Aktakuza në lidhje me këtë akuzë është e paqartë dhe nuk paraqet një shpjegim të pranueshëm se si i pandehuri e organizoi, e formoi etj., grupin kriminal. Ajo pretendon se i pandehuri nuk mund t’i kishte pastruar paratë siç pretendohet në Aktakuzë, pasi që paratë në shumën 669,000 euro nuk ishin të tijat, ai nuk kishte bazë ligjore që t’i kishte ato në dispozicion të tij, aq më pak t’ua transferonte ato kompanive të tjera, siç deklarohet në dispozitivin nën Akuzën 1 të Aktakuzës.

Gjetja e gjykatës

59. Kjo gjykatë gjen se ka dyshim të mirë-bazuar se e pandehura N.V., në bashkëpunim me F.B., me dijeni dhe në mënyrë të paligjshme organizoi përmes kontaktit me përfaqësues të kompanive të ndryshme, konkretisht B.B., E.D., I.F., dhe N.Th., transferimin e **669,000 eurove** të parave të vjedhura të përshkruara më lart tek këto kompani, për të fshehur dhe maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen, lëvrimin, lëvizjen ose pronësinë e këtyre

parave që pretendohet të jenë të vjedhura. Kjo gjetje mbështetet nga deklaratat e të pandehurve dhe pasqyra bankare e kompanisë së të pandehurës N.V.

60. Ka dyshim të mirë-bazuar se të pandehurit e lart-përmendur formuan një grup të organizuar kriminal, që ishte i strukturuar dhe përbëhej nga më shumë se tre persona, që ekzistoi nga dhjetori 2011 deri në nëntor 2012, me qëllimin e kryerjes së veprës penale të pastrimit të parave, konkretisht pastrimit të produkteve nga paratë që pretendohet se u përvetësuan në mënyrë të jashtëligjshme, siç përshkruhet në Akuzën 4 të kësaj Aktakuze në lidhje me këtë të pandehur.
61. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e krimit të organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) të vitit 2003, është kryer nga ky i pandehur.

C) I pandehuri B.B.

62. Aktakuza e ngarkon të pandehurin B.B., me tre (3) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Pranim i mallrave të vjedhura.

63. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

64. Akuzu pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri B.B., duke kryer kështu veprën penale të pastrimit të parave. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 14 dhjetor 2011, i pandehuri B.B., si pronar i F.O., dhe vëllai më i ri i të pandehurit F.B., (i cili ishte listuar si person i autorizuar për F.O.), pranoi nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., **20,000 euro** para të vjedhura. E pandehura N.V., tha se kjo ishte hua, por 13,000 euro mbetën të papaguara. Kurrë nuk u diskutua dhe nuk u përcaktua ndonjë marrëveshje me shkrim, kushte të shlyerjes ose kolateral. F.O., nuk ka fare të bëjë me pasaportat elektronike, OeSD-në ose MPB-në. Kjo transfertë iu bë Kompanisë së B.B., ditën pasi e pandehura N.V., mori 738,240 euro dhe 64,596 euro nga MPB. Paratë e vjedhura u transferuan përmes llogarisë bankare së F.O., për të fshehur, mbuluar ose maskuar transferimin e kundërligjshëm dhe të paligjshëm të parave të vjedhura tek i pandehuri B.B. I pandehuri B.B., gjithashtu i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., t'u shmangen pasojave ligjore të veprimeve të tyre duke e pranuar këtë shumë prej 20,000 eurosh në llogarinë bankare të F.O. Dhe kjo transfertë u bë qartazi për të nxitur veprimtarinë kriminale themelore të këtyre të pandehurve të njëjtë.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

65. Mbrojtja pretendon se "Që vepra penale e pastrimit të parave të ekzistojë, kushti themelor është që origjina e parave që vijnë në posedim, ose drejtpërdrejt ose përmes llogarive bankare, të jetë nga kryerja e ndonjë vepre. Klienti im nuk kishte dijeni për kontratën e lidhur ndërmjet MPB-së dhe operatorit ekonomik të përfaqësuar nga e dyshuara N.V., as kishte dijeni për transaksionet financiare të këtij operatori ekonomik."

Gjetja e gjykatës

66. Gjykata në këtë fazë arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se një pjesë e produkteve që kanë rrjedhur nga vepra penale e mashtrimit që mendohet të jetë kryer

nga e pandehura N.V., u transferuan në llogarinë bankare të F.O. Gjykata në këtë moment arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri dinte, ose kishte shkak të dinte, se këto para ishin produkte të një vepre penale. Ai ishte vëllai i F.B., dhe komunikimi me këtë të fundit jep tregues të qartë se i pandehuri B.B., kishte dijeni se paratë ishin produkte të kimit.

67. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri B.B., e ka kryer veprën penale e pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010.

Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

68. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri B.B., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri B.B., si pronar i F.O., dhe vëllai më i ri i të pandehurit F.B., (i cili ishte listuar si person i autorizuar i F.O.), pranoi më 14 dhjetor 2011 **20,000 euro para të vjedhura** nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V. E pandehura N.V., tha se kjo ishte hua por 13,000 euro mbetën të papaguara. Kurrë nuk u diskutua dhe nuk u përcaktua ndonjë marrëveshje me shkrim, kushte të shlyerjes ose kolateral. F.O., nuk ka fare të bëjë me pasaportat elektronike, O.,-në ose MPB-në. Kjo transfertë iu bë Kompanisë së B.B., ditën pasi e pandehura N.V., pranoi 738,240 euro dhe 64,596 euro nga MPB. Paratë e vjedhura u transferuan përmes llogarisë bankare të F.O., për të fshehur, mbuluar ose maskuar transfertën e kundërligjshme dhe të paligjshme të parave të vjedhura tek i pandehuri B.B. I pandehuri B.B., gjithashtu i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve*

të tyre duke e pranuar këtë shumë prej 20,000 eurosh në llogarinë bankare të F.O. Dhe kjo transfertë u bë qartazi për të nxitur veprimtarinë kriminale themelore të këtyre të pandehurve të njëjtë.

Gjetja e gjykatës

69. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave u krye nga i pandehuri, gjykata arrin në përfundimin se ka njëkohshmëri të veprave penale. Posaçërisht, vepra penale e pastrimit të parave konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Në këtë rast i pandehuri, nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me veprën penale të pastrimit të parave, që është vepër penale komplekse dhe pranimi i produkteve të një krimi (në këtë rast paratë e vjedhura) është vetëm një komponent i veprës penale të pastrimit të parave, që konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura.

70. Prandaj, gjykata vendosi ta rrëzojë Aktakuzën në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

71. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri B.B., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 14 dhjetor 2011, i pandehuri B.B., si pronar i F.O., dhe vëllai më i ri i të pandehurit F.B., (i cili ishte listuar si person i autorizuar i F.O.), pranoi **20,000 euro para të vjedhura** nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V. E pandehura N.V., tha se kjo ishte hua, por 13,000 euro mbetën të papaguara. Kurrë nuk u diskutua dhe nuk u përcaktua ndonjë marrëveshje me shkrim, kushte të shlyerjes ose kolateral. F.O., nuk ka fare të bëjë me pasaportat elektronike, O., në ose MPB-në. Kjo transfertë iu bë B.B., ditën pasi e*

*pandehura N.V., në mënyrë të paligjshme dhe të kundërligjshme, mori 738,240 euro dhe 64,596 euro nga MPB. Shuma 20,000 euro e parave të vjedhura u transferua në llogarinë bankare të F.O., për të fshehur, mbuluar ose maskuar një pjesë të shumës prej 1,420,255.13 eurosh që e pandehura N.V., i vodhi MPB-së dhe O. Gjithashtu, kjo qartazi i siguroi Kompanisë F.O., të B.B., një përfitim ekonomik të paligjshëm dhe të kundërligjshëm. Më 27 qershor 2011, i pandehuri B.B., pranoi një transfertë në shumën **35,000 euro** nga F.B., dhe më 5 maj 2012, B.B., transferoi 6,000 euro në llogarinë bankare në Raiffeisen të F.B. Më 11 nëntor 2012, natën e arrestimit të të pandehurve N.V., F.B., dhe B.B., u gjet në posedim të 2,000 eurove në para të gatshme me një automjet. Ekzaminimi forensik i telefonit të B.B., zbulon një tekst-mesazh nga vëllai i tij, F.,, “A kreve ndonjë punë?”, “të gjithën?” së cilës Betimi i përgjigjet “përveç zyrave.” Kjo sugjeron qartë se B.B., po e ndihmonte vëllain e tij F.B., në shkatërrimin e provave të krimeve të tyre para arrestimit të tyre, dhe kjo ishte pjesë e një plani për t’u shpëtuar autoriteteve. B.B., nuk ua raportoi asnjëherë Autoriteteve të Administratës Tatimore ndonjë pjesë të 20,000ve euro që mori.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

72. Mbrojtja pretendon se “nuk dihet çfarë lloj organizate është, hierarkia në këtë organizatë, fusha e veprimit të kësaj organizate dhe kryerja e veprave të caktuara. Kërkohen të gjitha këto elemente për t’i kualifikuar veprimet e një të dyshuari si veprime që kanë rrjedhur nga ekzistenca e veprës penale të krimit të organizuar në këtë rast.

Gjetja e gjykatës

73. Gjykata gjen se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e pranoi shumën prej 20,000.00 eurosh nga e pandehura N.V., me dijeninë se këto para ishin produkte të krimit, me qëllim fshehjen, maskimin ose mbulimin e natyrës së vërtetë të parave në fjalë. Gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri B.B., ishte pjesë e

grupit të organizuar kriminal, të formuar nga e pandehura N.V., dhe F.B., me qëllimin e pastrimit të produkteve të veprës penale të mashtrimit.

D) I pandehuri E.D.

74. Aktakuza e ngarkon të pandehurin E.D., me katër (4) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 4: Shmangie nga tatimi

75. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

76. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri E.D., duke kryer kështu veprën penale të Pastrim i parave. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga dhjetori 2011 deri në shkurt 2012, në Prishtinë, i pandehuri E.D., në bashkë-kryerje me të pandehurit N.V., dhe F.B., dhe të tjerët, pranoi shumën e përgjithshme të **400,000 eurove para të vjedhura** në llogarinë bankare të "kompanisë" së tij P., dhe Q., nga llogaria bankare e së pandehurës N.V., si rezultat i lidhjes së ngushtë të tij me të pandehurin F.B., dhe me planin e "pastrimit" ose fshehjes së parave. Nuk u lidh asnjë marrëveshje me shkrim, nuk pati kushte të rikthimit ose kolateral lidhur me transferimin e 400,000 euro tek P., dhe Q. Pastaj pretendohet se i pandehuri E.D., i përdori paratë e vjedhura për një projekt restoranti të ndodhur në Stadiumin Komunal në*

Prishtinë dhe për të furnizuar me pllaka qeramike sallën e ekspozimit të Qeramikës. Duke pranuar dhe pastaj tërhequr 400,000 euro para të vjedhura, i pandehuri E.D., ndihmoi N.V., F.B., dhe të tjerë për t'i shndërruar paratë e vjedhura, me qëllimin e fshehjes dhe "pastrimit" të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, lëvrimin, lëvizjes ose pronësisë së parave, dhe për t'iu shmangur pasojave ligjore ose të dukshme ligjore të veprimeve të tyre, dhe me veprime të tilla qartazi nxiti veprimtarinë kriminale themelore. Disa prej pllakave qeramike që pretendohet se u blenë me paratë e vjedhura, u përdorën në këmbim të blerjes së një banese me vlerë 45,000 euro në Mati 1, Prishtinë, që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje. Si P., ashtu dhe Q., nuk kanë mjete në llogaritë bankare të tyre dhe restoranti nuk është përfunduar, as është hapur ndonjëherë.

Kundërshtimi i mbrojtjes

77. Mbrojtja pretendon se i pandehuri mori hua përmes kompanisë "P." shumën 200,000.00 euro nga F.B., me qëllim që t'i investonte në një restorant që ndodhet në mjediset e Stadiumit Prishtina. Mbrojtja deklaron se i pandehuri nuk kishte asnjë detyrim për ta pyetur huadhënësin për origjinën e parave që ai është i interesuar të huazojë.
78. Më tej, mbrojtja pretendon se i pandehuri përmes kompanisë "Q." pranoi nga kompania e të pandehurve F.B., dhe N.V., shumën 200,000.00 euro si parapagim për pllakat. Sipas mbrojtjes, kjo nuk mund të kualifikohet si pastrim i parave, sepse kjo është marrëdhënie kontraktuale ndërmjet palëve.

Gjetja e gjykatës

79. Gjykata vëren se nuk është kontestuar se i pandehuri e pranoi shumën e 400,000.00 eurove. I pandehuri e pranoi shumën e 200,000.00 eurove në llogarinë bankare të kompanisë së quajtur "P." dhe të njëjtën shumë parash në llogarinë bankare të

kompanisë së quajtur "Q.". Gjithashtu nuk kontestohet se nuk ka pasur marrëveshje me shkrim në të cilat u bazuan këto pagesa.

80. I pandehuri pretendon se i pandehuri tjetër F.B., i huazoi atij shumë prej 200,000.00 eurosh. Për këtë nuk u bë ndonjë marrëveshje me shkrim. Po kështu, F.B., mohon të ketë të bëjë me këtë transfertë dhe po kështu edhe e pandehura N.V.
81. Në këto rrethana, gjykata është e bindur se ka dyshim të mirë-bazuar se transfertat u bënë me qëllimin e fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, lëvritimit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë, si dhe për ta ndihmuar të pandehurën në kryerjen e veprës penale të mashtrimit, si dhe e nxitën këtë vepër penale.
82. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të vitit 2010, paragrafët 2(1), 2(2), 2(4) dhe 2(5) të këtij neni.

Akuza 3: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

83. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri E.D., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga dhjetori 2011 deri në shkurt 2012, në Prishtinë, i pandehuri Dogani pranoi **400,000 euro para të vjedhura** në llogaritë bankare të Pirros dhe Qeramikës të tij nga llogaria bankare e së pandehurës Velija, si rezultat i miqësisë së ngushtë me Fisnik Blakajn. Për këtë nuk u lidh asnjë marrëveshje me shkrim, nuk u vendosën kushte të rikthimit ose kolateral. Pastaj i pandehuri Dogani pretendohet se i përdori paratë e vjedhura për një projekt për restorant të ndodhur në Stadiumin Komunal në Prishtinë dhe për të furnizuar me pllaka qeramike sallën e ekspozimit të Qeramikës. Disa prej këtyre pllakave qeramike*

u përdorën në këmbim të blerjes së një banese me vlerë 45,000 euro në zonën Mati 1, Prishtinë. As Pirro dhe as Qeramika nuk kanë para në llogaritë bankare të tyre dhe restoranti nuk është përfunduar, as është hapur ndonjëherë.

Gjetja e gjykatës

84. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave është kryer nga i pandehuri, gjykata arrin në përfundimin se ka njëkohshmëri të veprave penale. Posaçërisht, vepra penale e pastrimit të parave konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Në këtë rast i pandehuri, nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me veprën penale të pastrimit të parave, që është vepër penale komplekse, dhe pranimi i produkteve të një krimi (në këtë rast paratë e vjedhura) është vetëm një komponent i veprës penale të pastrimit të parave, që konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura.

85. Prandaj, gjykata vendosi ta rrëzojë Aktakuzën në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 4: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

86. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri E.D., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Nga dhjetori 2011 deri në shkurt 2012, kompanitë P., dhe Q., të të pandehurit E.D., morën shumën e përgjithshme të 400,000 eurove të parave të vjedhura që N.V., nuk ia transferoi kurrë O. I pandehuri E.D., me dashje nuk veproi dhe nuk e raportoi asnjëherë ndonjëherë prej këtyre të ardhurave të paligjshme tek Autoritetet e Administrimit të Tatimeve, as i pagoi AT-së ndonjë tatim lidhur me këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se Q., dhe pronarët e saj, J.B., dhe E.D., kishin qarkullim të padeklaruar në shumën 129,310.34 euro dhe i kanë AT-së një detyrim prej **20,689.65 eurosh** për shmangien nga*

*tatimi në vitin 2012. Hetimi i AT-së tregon gjithashtu se Pirro kishte një qarkullim të padeklaruar prej 200,000 eurosh dhe një detyrim prej **44,831.54 eurosh** për shmangien nga tatimi në vitin 2012.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

87. Mbrojtja pretendon se arsyeja përse i pandehuri nuk ua raportoi të ardhurat autoriteteve tatimore ishte sepse kompania Q., nuk i lëvroi mallrat, konkretisht pllakat qeramike, dhe kjo është arsyeja përse nuk u lëshuan fatura, prandaj të ardhurat nuk u raportuan.
88. Në lidhje me mosdeklarimin e të ardhurave të kompanisë P., mbrojtja pretendon se të ardhurat ishin huazuar, prandaj kompania nuk ishte e detyruar t'ia deklaronte këto autoriteteve tatimore.
89. Më tej, mbrojtja pretendon se Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë zbatohet në këtë lëndë në gjithë territorin e Kosovës, prandaj kjo vepër penale është falur.

Gjetja e gjykatës

90. Gjykata vëren se nuk është kontestuar se i pandehuri pranoi shumën e përgjithshme të 400,000 eurove nga kompania e së pandehurës N.V., – 200,000 euro u pranuan në llogarinë bankare të Kompanisë Q., dhe 200,000 euro të tjera u pranuan në llogarinë bankare të Kompanisë P.
91. Gjykata ka përcaktuar tashmë se ka dyshim të mirë-bazuar se këto para u transferuan nga e pandehura N.V., tek këto kompani me qëllimin që të pastronte produktet e krimit.
92. Prandaj, duke pasur parasysh se këto janë të ardhura të paligjshme dhe se ato janë objekt tatimi, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri e ka kryer veprën penale të shmangies nga tatimi, në shkelje të nenit 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat të vitit 2010 (TAP).
93. Gjykata nuk pajtohet me argumentin e mbrojtjes se vepra penale e shmangies nga tatimi është falur nga Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë. Gjuha përkatëse e këtij Ligji është si vijon:

1.2. Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës (Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 2003/25) dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:

1.2.8. Thirrja për rezistencë (neni 319) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit edhe **kryesit e këtyre veprave penale më poshtë të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:**

...

1.2.8.3. Shmangie nga tatimi (Neni 249); [theksi i shtuar]

Siç mund të vërehet nga gjuha e ligjit, vepra penale e shmangies nga tatimi falet vetëm nëse ajo është kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale të 'thirrjes për rezistencë'. Në këtë lëndë as prokurori, as mbrojtja nuk pretenduan që vepra penale e shmangies nga tatimi ishte kryer kinse me qëllim të kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë. Prandaj gjykata e hedh poshtë këtë argument të mbrojtjes si të pabazuar.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

94. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri E.D., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

I pandehuri E.D., e ka njohur të pandehurin F.B., për 13-14 vjet dhe e konsideron atë shok të mirë. I pandehuri E.D., regjistroi një kompani me emrin P., në fund të vitit 2008, me qëllim të sigurisë, por fitoi shumë pak para, prandaj vendosi të investonte në një projekt për restorant në Stadiumin

Komunal në Prishtinë. Të pandehurit F.B., dhe N.V., ofruan t'i "huazojnë" 200,000 euro kompanisë P., të të pandehurit E.D., për projektin e restorantit, megjithëse nuk ka marrëveshje me shkrim, as u vendosën kushte të rikthimit dhe as kolateral. I pandehuri E.D., nuk i pyeti asnjëherë N.V., dhe F.B., ku ose si ata dolën me një shumë kaq të madhe parash, që ata ishin të gatshëm ta transferonin në llogarinë bankare të Kompanisë P., të E.D. Më 14 dhjetor 2011, të pandehurit F.B., dhe N.V., transferuan tek Pirro **200,000 euro** të parave të vjedhura të përshkruara më lart. I pandehuri E.D., pretendon se të gjitha paratë janë përdorur për projektin e restorantit. Të gjitha paratë e vjedhura u tërhoqën nga i pandehuri E.D., brenda 24 orëve të marrjes së tyre. Asnjë shumë nga këto para nuk u është kthyer ndonjëherë të pandehurve F.B., ose N.V., as të pandehurit F.B., ose N.V., nuk kanë kërkuar ndonjëherë t'u kthehen paratë. Llogaria bankare e P., ka qenë dhe mbetet e zbrazur që kur E.D., i tërhoqi mjetet. Restoranti nuk është përfunduar, as hapur ndonjëherë. Materialet e këtij restoranti janë objekt i një urdhri bashkëngjitjeje.

Në janar 2012, i pandehuri E.D., gjithashtu themeloi një të ashtuquajtur kompani të pllakave qeramike me emrin Q. Menjëherë pasi e regjistroi kompaninë, E.D., pranoi, përmes Q., **100,000 euro para të vjedhura** nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., më 22 shkurt 2012 dhe **100,000 euro** të tjera më 1 mars 2012. Pretendohet se paratë u transferuan për "pagesë për mallra, për qeramikë dhe materiale", me të cilat të pandehurit N.V., dhe F.B. "... po zbatonin një projekt, po ndërtonin diçka...", megjithëse E.D., nuk ka marrë kurrë urdhër për pllaka qeramike apo ndonjë gjë tjetër, dhe nuk ka marrëveshje me shkrim, as janë vendosur kushte të rikthimit ose ndonjë kolateral. Përsëri, E.D., nuk i pyeti asnjëherë të pandehurit N.V., ose F.B., se si dhe ku i kishin siguruar ata shuma kaq të mëdha parash. Të pandehurit N.V., dhe F.B., nuk kanë kërkuar asnjëherë t'u kthehen paratë. I pandehuri E.D., pranoi se kishte transferuar 135,000 euro të parave të Q., në llogarinë bankare të P., me qëllimin e financimit të projektit të restorantit. Më vonë ai transferoi 60,000 euro përsëri në llogarinë bankare të Q. I pandehuri J.B., i cili është bashkë-pronar i Q., pranoi në intervistën me të si i pandehur se 100,000 eurot

para të vjedhura të pranuar nga llogaria bankare CE e Velijas u përdorën për të blerë pllaka qeramike për sallën e tyre të ekspozimit dhe pastaj u përdorën në këmbim të blerjes së një banese në Mati 1, Prishtinë, me vlerë rreth 45,000 euro, që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje. As në llogarinë bankare të Q., as në llogarinë bankare të P., nuk ka mjete. Këto transfertë ishin qartazi pjesë e një plani të organizuar, në pjesëmarrje me të pandehurit N.V., F.B., dhe të tjerë për të "pastruar," fshehur, maskuar ose mbuluar natyrën, burimin, vendndodhjen, ose pronësinë e parave të vjedhura. Më tej, ato i siguruan të pandehurit E.D., dhe të ashtuquajturave kompani P., dhe Q., një përfitim ekonomik të madh, të paligjshëm dhe të kundërligjshëm, në kurriz të të dëmtuarve O., MPB dhe qytetarëve të Kosovës.

Kundërshtimi i mbrojtjes

95. Mbrojtja deklaron se arsyeja përse klienti i saj kërkoi mjete nga F.B., ishte për faktin se ai e dinte se F.B., ishte biznesmen dhe se mund t'i merrte atij hua mjete financiare për Kompaninë "P." pa ndonjë problem. Arsyeja përse nuk u bë marrëveshje me shkrim, nuk mund të inkriminohet me elementet e një veprë penale, sepse kompania në fjalë i pranoi paratë përmes një llogarie bankare të ligjshme, dhe kjo transfertë parash u regjistrua në transaksionin bankar si huamarrje, dhe në këtë pikë ne nuk mund të arrijmë në përfundimin se nuk ka pasur marrëveshje me shkrim, sepse në bankë janë paratë e regjistruara, të pranuar nga klienti im.
96. Më tej, mbrojtja deklaron se shuma prej 200,000.00 eurosh u investua për restorantin dhe për këtë të gjitha provat, të tilla si faturat e materialeve të blera, projekteve dhe shpenzimeve të tjera, i janë dorëzuar prokurorit të lëndës, por kjo mund të verifikohet edhe duke këqyrur vendin, ku mund të verifikohet përmes shikimit të drejtpërdrejtë të objektit, ku shihet qartë se investimi për restorantin në fjalë u bë.

97. Me një fjalë, mbrojtja pretendon se i pandehuri nuk është përfshirë në grupin e organizuar kriminal dhe nuk ka prova për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të krimit të organizuar.

Gjetja e gjykatës

98. Gjykata ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të pastrimit të parave. Në të njëjtën kohë, gjykata përcaktoi se të pandehurit N.V., F.B., dhe B.B., e kanë kryer veprën penale të krimit të organizuar. Gjykata vëren se i pandehuri pranoi shumën e 400,000.00 eurove në lidhje me të cilat nuk ekziston marrëveshje me shkrim. Po kështu, ka dyshim të mirë-bazuar se paratë që u pranuan, buruan nga kryerja e një vepre penale. I pandehuri e ka njohur F.B., për një periudhë të gjatë kohë. Gjithashtu, paratë që iu transferuan atij, u tërhoqën menjëherë nga llogaria bankare.

99. Të gjitha këto rrethana shpjen në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të krimit të organizuar.

E) I pandehuri I.F.

100. Aktakuza e ngarkon të pandehurin I.F., me katër (4) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 4: Shmangie nga tatimi.

101. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

102. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri I.F., duke kryer kështu veprën penale të pastrimit të parave. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 19 dhe 27 dhjetor 2011, kompania R.I., e të pandehurit I.F., pranoi shumën e përgjithshme të **200,000 eurove** nga llogaria bankare e së pandehurës N.V., pasi ishte takuar disa herë me të pandehurin F.B., dhe pastaj më vonë me të pandehurën N.V. Këto para ishin kinse për një projekt për spital për rreth 1.5 milionë euro. Të 200,000 eurot ishin para të vjedhura, që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së. I pandehuri I.F., tërhoqi pjesën më të madhe të parave menjëherë pasi mori paratë e vjedhura dhe u largua nga kompania e tij R.I., disa muaj më vonë. Asnjëherë nuk u diskutua për ndonjë marrëveshje me shkrim, kushte të rikthimit ose kolateral për këtë projekt për spital dhe I.F., nuk i pyeti asnjëherë të pandehurit F.B., ose N.V., se ku dhe si ata e kishin siguruar një shumë kaq të madhe parash për t'ia dhënë I.F. Me gjithë kërkesat e shumta nga EULEX, i pandehuri I.F., nuk ka treguar asnjëherë ndonjë provë se bëri diçka me paratë, përveç se i ka vjedhur. Llogaria bankare e R.I., ka mbetur e zbrazur që kur i pandehuri I.F., tërhoqi pjesën më të madhe të parave të vjedhura para më se një viti. I.F., i mori paratë e vjedhura për të "pastruar," fshehur, maskuar ose mbuluar natyrën, burimin, vendndodhjen ose pronësinë e tyre. Më tej I.F., i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tyre, duke i pranuar këto para të vjedhura të shpëlara dhe më tej ai nxiti veprimtarinë kriminale themelore të të pandehurës N.V., dhe F.B., duke i pranuar dhe vjedhur këto 200,000 euro.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

103.Mbrojtësi pretendon se veprat penale të pastrimit të parave janë përfshirë në Ligjin për Amnistinë, Nr. 04/L-209.

Gjetja e gjykatës

104.Gjykata gjen se argumenti i mbrojtjes është i pabazuar. Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë nuk e fal veprën penale të pastrimit të parave.

105.Më tej, gjykata vëren se nuk është kontestuar se i pandehuri e pranoi shumën 200,000.00 euro në llogarinë bankare të kompanisë së tij. Ka dyshim të mirë-bazuar se këto para janë produkte të veprës penale të mashtrimit. Për këto para nuk ka ndonjë marrëveshje me shkrim ndërmjet të pandehurve I.F., dhe N.V., ose F.B. E pandehura N.V., pretendon se ajo nuk e njeh të pandehurin. Ky veprim i të pandehurit i shërbeu dhe e ndihmoi të pandehurën N.V., në përpjekjen e saj për ta paraqitur këtë si pagesë për rryshfet për zyrtarët e MPB-së para përfaqësuesve të O.,-së. Deklarata e këtij të pandehuri është në kundërshtim të plotë me deklaratat e F.B., dhe N.V. Prandaj gjykata është e mendimit se ka dyshim të mirë-bazuar se N.V., dhe F.B., në bashkëpunim me të pandehurin I.F., kryen veprën penale të pastrimit të parave.

106.Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të vitit 2010, paragrafët 2(1), 2(2), 2(4) dhe 2(5).

Akuzë 3: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

107. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri I.F., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 19 dhe 27 dhjetor 2011, kompania R.I., e të pandehurit I.F., pranoi shumën e përgjithshme të **200,000 eurove** nga llogaria bankare e së pandehurës N.V., pasi u takua disa herë me të pandehurin F.B., dhe pastaj më vonë me të pandehurën N.V. Këto ishin kinse për një projekt për spital për rreth 1.5 milionë euro. Të 200,000 eurot ishin para të vjedhura që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.-së. I pandehuri I.F., e tërhoqi pjesën më të madhe të parave menjëherë pas marrjes së mjeteve, dhe u largua nga kompania e tij R.I., disa muaj më vonë. Për këtë projekt kinse për spital nuk pati kurrë ndonjë marrëveshje me shkrim, nuk u vendosën kushte të rikthimit ose kolateral dhe, me gjithë kërkesat e shumta nga EULEX, i pandehuri I.F., nuk ka treguar asnjëherë ndonjë vërtetim me shkrim të ndonjë gjëje të blerë, të planifikuar ose të ndërtuar. As të pandehurit N.V., dhe F.B., nuk kanë kërkuar ndonjëherë t'u kthehen e paratë dhe i pandehuri I.F., nuk i pyeti asnjëherë se ku ose si ata e kishin siguruar një shumë kaq të madhe. Llogaria bankare e R.I., ka mbetur e zbrazur që kur i pandehuri I.F., tërhoqi pjesën më të madhe të parave të vjedhura.*

Gjetja e gjykatës

108. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave u krye nga i pandehuri, gjykata arrin në përfundimin se ka njëkohshmëri të veprave penale. Posaçërisht, vepra penale e pastrimit të parave konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Në këtë rast i pandehuri, nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me veprën penale të pastrimit të parave, që është vepër penale komplekse, dhe pranimi i produkteve të një krimi (në këtë rast paratë e vjedhura) është vetëm një komponent i veprës penale të pastrimit të parave, që konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura.

109. Prandaj gjykata vendosi ta rrëzojë Aktakuzën në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 4: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

110. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri I.F., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 19 dhe 27 dhjetor 2011, i pandehuri I.F., pranoi shumën e përgjithshme të **200,000 eurove** për kompaninë e tij R.I., nga paratë e vjedhura që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së. I pandehuri I.F., e tërhoqi pjesën më të madhe të parave menjëherë pas marrjes së mjeteve dhe asnjëherë nuk planifikoi, ndërtoi, projektoi ose bleu ndonjë gjë me paratë e vjedhura që kinse ishin për një projekt për spital. Ai u largua nga R.I., disa muaj më vonë dhe llogaria bankare e kompanisë ka mbetur e zbrazur që kur ai i tërhoqi paratë e vjedhura. Ai me dashje nuk veproi dhe nuk ia raportoi AT-së ndonjëherë prej këtyre të ardhurave të paligjshme, as pagoi ndonjë tatim për këto para të vjedhura, tatim që e kalon shumën e 20,000 eurove. Një hetim i kryer nga AT tregon se R.I., ka përgjegjësi ligjore për **81,477.22 euro** për shmangie nga tatimi për vitin fiskal 2011 dhe ka përgjegjësi ligjore për shumën e përgjithshme të **197,125.60 eurove** për vitet 2007-2013. Detyrimi tatimor për vitin 2012 është **29,708.14 euro***

Kundërshtimi i mbrojtjes

111. Mbrojtësi pretendon se vepra penale e pastrimit të parave është përfshirë në Ligjin për Amnistinë, Nr. 04/L-209.

Gjetja e gjykatës

112. Gjykata gjen se argumenti i mbrojtjes se kjo veprë penale është përfshirë në Ligjin për Amnistinë, është i pabazuar. Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë nuk e fal veprën penale të shmangies nga tatimi drejtpërdrejt. Kjo veprë penale falej vetëm po të ishte kryer në lidhje me veprën penale të thirrjes për rezistencë.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

113. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri I.F., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri I.F., ishte listuar si pjesëmarrës i autorizuar në një kompani ndërtimi, R.I., në pronësi të të pandehurit S.Sh. Pasi e takoi të pandehurin F.B., disa herë dhe pastaj më vonë të pandehurën N.V., në llogarinë bankare të R.I., më 19 dhjetor 2011 u transferuan **100,000 euro para të vjedhura** që N.V., nuk ia transferoi OESD-së, dhe më 27 dhjetor 2011 në këtë llogari u transferuan **100,000 euro** të tjera. Qëllimi i pretenduar i këtyre transfertave ishte një projekt për spital me një kosto të përafërt prej 1.5 milionë eurosh, që është shuma e përafërt që N.V., i vodhi MPB-së dhe O.,-së. Për këtë projekt për spital nuk pati kurrë ndonjë marrëveshje me shkrim, as u diskutuan kushte të rikthimit ose kolateral për këtë të ashtuquajtur projekt për spital. I.F., nuk i pyeti asnjëherë të pandehurit F.B., ose N.V., se ku ose si e kishin siguruar ata një shumë kaq të madhe parash për t'ia dhënë I.F. Dhe as të pandehurit N.V., ose F.B., nuk kanë kërkuar t'u kthehen këto para. Me gjithë kërkesat e shumta nga EULEX, i pandehuri I.F., nuk ka treguar asnjëherë se bëri ndonjë gjë me paratë, përveç se i ka vjedhur. I pandehuri I.F., tërhoqi pjesën më të madhe të parave menjëherë pas transfertave dhe llogaria bankare e R.I., ka qenë e zbrazur që nga ajo kohë. I pandehuri I.F., u largua nga kompania R.I., disa*

muaj pasi kishte marrë 200,000 eurot. I pandehuri I.F., i pranoi këto transferta në shumën e përgjithshme të 200,000 eurove në kuadrin e një grupi të organizuar kriminal për të "pastruar," fshehur, maskuar, ose mbuluar natyrën, burimin, vendndodhjen, ose pronësinë e parave të vjedhura. Më tej ai pranoi një përfitim ekonomik shumë të madh, të paligjshëm dhe të kundër-ligjshëm për të ashtuquajturën kompani R.I., të tij, në kurriz të të dëmtuarve O., MPB dhe popullit të Kosovës.

Kundërshtimi i mbrojtjes

114.Mbrojtja pretendon indirekt se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se kjo vepër penale është kryer.

Gjetja e gjykatës

115.Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave është kryer, gjykata gjen se ka dyshim të mirë-bazuar se është kryer edhe vepra penale e krimit të organizuar. Veprimet e këtij të pandehuri kontribuan ndjeshëm në fshehjen dhe maskimin e natyrës së parave që ishin produkte të krimit. Dijenja e të pandehurit rrjedh nga fakti se nuk pati ndonjë kontratë me shkrim, me gjithë faktin se prej tij u pranua një shumë e madhe parash kinse për ndërtimin e një spitali. Në këtë pikë, provat e paraqitura nga prokurori mjaftojnë që gjykata të përcaktojë dyshimin e mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të vënë në barrë në Aktakuza.

116.Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të krimit të organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafët (1), (2), (4) dhe (7) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 283 i KPK-së së vitit 2013)

F) I pandehuri N.Th.,

117.Aktakuza e ngarkon të pandehurin N.Th., me katër (4) akuza:

Akuza 1: Krim i organizuar;

Akuza 2: Pastrim i parave;

Akuza 3: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 4: Shmangie nga tatimi

118. Për t'i analizuar në mënyrën e duhur veprat penale me të cilat akuzohet i pandehuri, është e nevojshme që Akuza e krimit të organizuar të analizohet në fund. Në fillim duhen vlerësuar pretendimet e prokurorit lidhur me veprat themelore.

Akuza 2: Pastrimi i parave

Pretendimi i prokurorit

119. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri N.Th., duke kryer kështu veprën penale të pastrimit të parave. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 28 shkurt 2012, A.Th., djali i të pandehurit N.Th., themeloi një kompani të quajtur C.B. Megjithatë N.Th., pranoi se kompaninë e menaxhon dhe e administron ai. Të nesërmen, më 1 mars 2012, e pandehura N.V., transferoi **20,000 euro** në llogarinë bankare të C.B.. I pandehuri N.Th., e ka njohur të pandehurin F.B., për shumë vjet, që para luftës së vitit 1999. Bashkëshortja e të pandehurit N.Th., e ka njohur të pandehurën N.V., që kur ishin fëmijë. Më 30 gusht 2012, C.B., pranoi gjithashtu një transfertë bankare tjetër në shumën **49,000 euro** nga llogaria bankare e së pandehurës N.V. Të dy këto transfertat erdhën nga paratë e vjedhura që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së. A.Th., djali i të pandehurit N.Th., është pronari i regjistruar i C.B., ndonëse është vetëm rreth 19 ose 20 vjeç. A.Th., shpjegoi se i pandehuri F.B., i kishte borxh babait të tij, N.Th., dhe se të dy transfertat bankare të parave të vjedhura ishin për të shlyer borxhet e F.B. A.Th., pranoi se pa transfertën e 20,000 eurove tek C.B., kompania nuk do të ishte nisur. N.Th., i tha A. Th., se këto para ishin për të shlyer borxhin e N.Th., ndaj të pandehurit F.B. Paratë e*

vjedhura shkuan përmes kompanisë C.B., të A.Th., në kuadrin e planit të organizuar të të pandehurve N.V., F.B., dhe N.Th., për të pastruar paratë e vjedhura dhe për të fshehur, mbuluar ose maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen ose pronësinë e tyre. N.Th., i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tyre nga pranimi i kësaj shume 69,000 euro dhe për rrjedhojë ai nxiti veprimtarinë kriminale thelbësore. Më tej ai pranoi një përfitim ekonomik të madh, të kundër-ligjshëm dhe të paligjshëm për C.B., dhe sigurisht për veten e vet. Hetimi më i fundit nuk zbulon pothuajse asnjë shumë parash në llogarinë bankare të C.B.

Kundërshtimi i mbrojtjes

120.Mbrojtja pretendon se akuzat kundër këtij të pandehuri siç përshkruhen në dispozitivin e Aktakuzës, nuk përbëjnë vepër penale.

Gjetja e gjykatës

121.Gjykata vëren se mbrojtja nuk i konteston faktet e pretenduara nga prokurori, por pretendon se këto fakte nuk përbëjnë vepër penale. Gjykata nuk pajtohet me këtë përfundim. Prokurori qartazi pretendon se i pandehuri N.Th., i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., t'u shmangen pasojave ligjore të veprimeve të tyre, duke marrë shumën e 69,000 eurove dhe për rrjedhojë ai nxiti veprimtarinë kriminale themelore të tyre. Akuza është më tej pretendon se i pandehuri mori një përfitim ekonomik të madh, të kundërligjshëm dhe të paligjshëm për C.B., dhe sigurisht për veten e vet. Hetimi i fundit nuk zbulon pothuajse asnjë para në llogarinë bankare të C.B.

122.Faktet e pretenduara nga prokurori përbëjnë veprën penale të pastrimit të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i vitit 2010, paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5.

Akuza 3: Pranimit i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

123. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri N.Th., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

I pandehuri N.Th., pranoi 20,000 euro më 1 mars 2012 dhe 49,000 euro më 30 gusht 2012 të parave të vjedhura, nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., pa lejen, dijeninë ose pëlqimin e O.,-së ose MPB-së. I pandehuri F.B., shleu një borxh personal që ia kishte të pandehurit N.Th., përmes këtyre transfertave nga llogaria bankare e së pandehurës N.V., dhe ai e fshehu qëllimin e këtyre transfertave që u bënë përmes llogarisë bankare të C.B., të N.Th.

Kundërshtimi i mbrojtjes

124. Mbrojtja bëri një pretendim të përgjithshëm për të gjitha akuzat e Aktakuzës: akuzat kundër të pandehurit nuk përbëjnë vepër penale.

Gjetja e gjykatës

125. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se vepra penale e pastrimit të parave është kryer nga i pandehuri, gjykata arrin në përfundimin se ka njëkohshmëri të veprave penale. Posaçërisht, vepra penale e pastrimit të parave konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Në këtë rast i pandehuri, nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me veprën penale të pastrimit të parave, që është vepër penale komplekse, dhe pranimi i produkteve të një krimi (në këtë rast paratë e vjedhura) është vetëm një komponent i veprës penale të pastrimit të parave, që konsumon veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura.

126. Prandaj, gjykata vendosi ta rrëzojë Aktakuzën në lidhje me këtë akuzë të Aktakuzës.

Akuza 4: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

127. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri N.Th., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri N.Th., pranoi shumën e përgjithshme të **69,000 eurove para të vjedhura**, që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së, dhe paratë e vjedhura u përdorën për të shlyer një borxh personal që F.B., ia kishte të pandehurit N.Th. Paratë u transferuan tek kompania C.B., e djalit të N.Th., për të fshehur faktin se paratë po përdreshin nga F.B., për të shlyer borxhin personal që i kishte N.Th. A.Th., i tërhoqi paratë dhe ia dha ato babait të tij, të pandehurit N.Th. N.Th., pranoi se praktikisht ai është menaxheri i kompanisë C.B., dhe se ai e administron kompaninë. N.Th., nuk ia raportoi kurrë AT-së 69,000 eurot, as pagoi ndonjë tatim lidhur me këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se C.B., nuk ia deklaroi të 49,000 eurot që pranoi nga paratë e vjedhura nga CE. Shuma që ai i detyrohet AT-së për shmangie nga tatimi në vitin 2012 është **10,983.00 euro**. Transferimi i 20,000 eurove u deklarua, por sipas AT-së ai është transaksion i dyshimtë.*

Për më tepër, përgjimi i telefonit të F.B., zbuloi një bisedë që ndodhi më 24 korrik 2013 në të cilën F.B., kontaktoi me telefonin e N.Th., dhe u përgjigj S.Sh. F.B., pyeti “a mund të lëshosh një vërtetim sikur ke punuar tek unë?” S.Sh., u përgjigj: “Ta shohim”. F.B., i thotë “hajde në zyrën time jam këtu bashkë me inspektorët e AT-së duke kontrolluar dokumentet”. Më vonë në të njëjtën mbrëmje, N.Th., thërret F.B., dhe ata diskutojnë për lëshimin e faturave për një autolarje. Nga këto biseda është e qartë se të pandehurit F.B., N.Th., dhe S.Sh., po punojnë bashkë dhe po përpiqen të shmangin pagesën e tatimit.

Kundërshtimi i mbrojtjes

128.Mbrojtja bëri një pretendim të përgjithshëm për të gjitha akuzat e Aktakuzës: akuzat kundër të pandehurit nuk përbëjnë vepër penale.

Gjetja e gjykatës

129.Gjykata gjen se prokurori pretendon se i pandehuri N.Th., nuk ia raportoi AT-së shumën e 69,000 eurove, as pagoi ndonjë tatim lidhur me këtë shumë. Fakti i pretenduar nga prokurori përbën vepër penale në shkelje të nenit 63 (1), (2) (2.5), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 2010.

Akuza 1: Krimi i organizuar

Pretendimi i prokurorit

130.Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri N.Th., duke kryer kështu veprën penale të krimit të organizuar. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*Më 28 shkurt 2012, A.Th., djali i të pandehurit N.Th., themeloi kompaninë e quajtur C.B. Megjithatë N.Th., pranoi se kompaninë e menaxhon dhe e administron ai. Të nesërmen, më 1 mars 2012, e pandehura N.V., transferoi **20,000 euro** në llogarinë bankare të C.B. I pandehuri N.Th., e ka njohur të pandehurin F.B., për shumë vite, që para luftës së vitit 1999. Bashkëshortja e të pandehurit N.Th., e ka njohur të pandehurën N.V., që kur ishin fëmijë. Më 30 gusht 2012, C.B., gjithashtu pranoi një transfertë tjetër bankare në shumën **49,000 euro** nga llogaria bankare e së pandehurës N.V. Të dy këto transferta erdhën nga paratë e vjedhura që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së. A.Th., djali i të pandehurit N.Th., është pronari i regjistruar i C. B., ndonëse ai është vetëm rreth 19 ose 20 vjeç. A.Th., shpjegoi se i pandehuri F.B., i kishte borxh babait të tij, N.Th., dhe se të dy transfertat bankare të parave të vjedhura ishin për të shlyer borxhin e F.B. A.Th., pranoi se pa transfertën e*

20,000 eurove tek C.B., kompania nuk do të ishte nisur. N.Th., i tha A.Th., se këto para ishin për të shlyer borxhin e N.Th., me të pandehurin F.B. Paratë e vjedhura shkuan përmes kompanisë C.B., të A.Th., në kuadrin e planit të organizuar të pandehurve N.V., F.B., dhe N.Th., për të pastruar paratë e vjedhura dhe për të fshehur, mbuluar ose maskuar natyrën, burimin, vendndodhjen ose pronësinë e tyre. N.Th., i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tyre nga pranimi i kësaj shume 69,000 euro dhe për rrjedhojë ai nxiti veprimtarinë kriminale themelore të tyre. Më tej ai pranoi një përfitim ekonomik të madh, të kundërligjshëm dhe të paligjshëm për C.B., dhe sigurisht për veten e vet. Hetimi më i fundit nuk zbulon pothuajse asnjë para në Llogarinë bankare të C.B.

Kundërshtimi i mbrojtjes

131.Mbrojtja bëri një pretendim të përgjithshëm për të gjitha akuzat e Aktakuzës: akuzat kundër të pandehurit nuk përbëjnë vepër penale.

Gjetja e gjykatës

132.Gjykata vëren se prokurori pretendon se N.Th., i ndihmoi të pandehurit N.V., dhe F.B., t'u shmangen pasojave ligjore të veprimeve të tyre duke pranuar këtë shumë 69,000 euro dhe për rrjedhojë ai nxiti veprimtarinë kriminale themelore të tyre. Më tej ai pranoi një përfitim ekonomik të madh, të kundërligjshëm dhe të paligjshëm për C.B., dhe sigurisht për veten e vet. Hetimi më i fundit nuk zbulon pothuajse asnjë mjet në Llogarinë bankare të C.B. Pasi ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se të pandehurit N.V., dhe F.B., formuan një grup kriminal, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri N.Th., me dijeni ishte pjesë e atij grupi.

133.Faktet e pretenduara nga prokurori përbëjnë veprën penale të krimit të organizuar. Kjo është sepse grupi ishte i strukturuar dhe përbëhej nga tre ose më shumë persona dhe qëllimi ishte të kryenin veprën e rëndë të pastrimit të parave.

G) I pandehuri J.B.

134.Aktakuza e ngarkon të pandehurin J.B., me dy (2) akuza:

Akuza 1: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 2: Shmangie nga tatimi

Akuzë 1: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

135.Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri J.B., duke kryer kështu veprën penale të pranimi të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

Në janar 2012, i pandehuri J.B., formoi kompaninë Q., me bashkë-pronar të pandehurin E.D. Menjëherë pas kësaj, Q., pranoi një transfertë 100,000 euro nga llogaria bankare e N.V., në NLB më 22 shkurt 2012, dhe 100,000 euro të tjera më 1 mars 2012. Të pandehurit J.B., dhe E.D., pretendojnë se këto para ishin me qëllimin e vetëm të pllakave të qeramikës, por nuk u bë absolutisht asgjë lidhur me këtë projekt, përveç transferimit të 135,000 eurove para të vjedhura në llogarinë bankare të P., për projektin për restorantin, dhe përdorimit të pjesës tjetër të parave për të furnizuar sallën e ekspozimit të tyre, që nuk kishte të bënte fare me të ashtuquajturin projekt. Asnjëherë nuk pati ndonjë marrëveshje me shkrim, nuk u vendosën kushte të rikthimit ose kolateral lidhur me këtë të ashtuquajtur projekt të pllakave qeramike. As i pandehuri J.B., as i pandehuri E.D., nuk pyetën ndonjëherë se ku ose si e kishin siguruar të pandehurit N.V., dhe F.B., një shumë kaq të madhe parash. Të

*pandehurit N.V., dhe F.B., nuk kërkuan asnjëherë t'u kthehen paratë. I pandehuri J.B., ishte në dijeni të transfertës së 135,000 eurove dhe me pjesën e mbetur të parave të vjedhura bëri blerje për sallën e tyre të ekspozimit. Gjithashtu ai bëri disa tërheqje në shumën e përgjithshme të **24,000 eurove para të vjedhura** për përdorim vetjak. Pllakat e blera nga salla e ekspozimit u përdorën për të blerë një banesë në çmimin e rreth 45,000 eurove, që është objekt i një urdhri bashkëngjitjeje. Llogaria bankare e Qeramikës është e zbrazur dhe i pandehuri J.B., pranoi se ata nuk kishin bërë asnjëherë ndonjë punë madhore në Q.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

136.Mbrojtja pretendon se nuk ka prova që të tregojnë se i pandehuri J.B., i përdori paratë e pranuar në llogarinë bankare të kompanisë.

137.Mbrojtja pretendon se çdo transaksion financiar u sqarua nga i pandehuri para prokurorit dhe gjithashtu ka provuar se nuk ka elemente të ndonjë vepre penale. Ai pretendon se partneri i tij, E.D., e informoi atë se ishte bërë një parapagesë për pllaka dhe ai nuk kishte arsye të besonte se po ndodhte diçka jo e rregullt.

Gjetja e gjykatës

138.Gjykata gjen se nuk është kontestuar se shuma prej 200,000.00 eurosh u transferua nga llogaria bankare e Kompanisë CE në llogarinë bankare të kompanisë Q., që u themelua në vitin 2012. Më tej, nuk është kontestuar se i pandehuri është njëri prej pronarëve të kompanisë. Shuma e 135,000.00 eurove u transferua në llogarinë bankare të P., me një sasi të madhe pllakash kinse të blera me paratë e mbetura. Ndërmjet të pandehurve N.V., dhe F.B., dhe të pandehurit J.B., nuk ka marrëveshje me shkrim lidhur me këtë transfertë. Të pandehurit N.V., dhe F.B., mohojnë të kenë urdhëruar ndonjë sasi pllakash.

139. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri J.B., e ka kryer veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura, në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 345 të KPK-së 2013).

Akuza 2: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

140. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri J.B., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri J.B., si bashkë-pronar i Q., me dijëni pranoi nga llogaria bankare e së pandehurës N.V., në NLB 100,000 euro më 22 shkurt 2012 dhe 100,000 euro të tjera më 01 mars 2012. Këto ishin paratë e vjedhura që e pandehura N.V., nuk ia transferoi O.,-së. I pandehuri J.B., me dijëni i përdori këto para për të furnizuar me pllaka qeramike sallën e ekspozimit dhe gjithashtu e dinte se këto pllaka qeramike u përdorën për të blerë një banesë me çmimin 45,000 euro. Po kështu, ai ishte në dijëni se partneri i tij, i pandehuri E.G., transferoi 135,000 euro në llogarinë bankare të Kompanisë P., të E.D., dhe pjesën më të madhe të këtyre parave i përdori për projektin e restorantit. I pandehuri J.B., si bashkë-pronar i Q., me dashje iu shmang pagesës së tatimeve për 200,000 eurot që mori Q. Më tej ai nuk ia raportoi AT-së këto të ardhura të paligjshme, siç kërkohet nga ligji, dhe nuk pagoi tatime për këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se Q., dhe pronarët e saj, J.B., dhe E.G., patën një qarkullim të deklaruar në shumën 129,310.34 euro dhe kishin një detyrim prej **20,689.65 eurosh** për shmangien nga tatimi në vitin 2012.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

141.Mbrojtja pretendon se vepra penale e shmangies nga tatimi është falur nga Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë.

142.Më tej, mbrojtja pretendon se nuk ka prova për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri.

Gjetja e gjykatës

143.Gjykata nuk bie dakord me argumentin e mbrojtjes se vepra penale e shmangies nga tatimi është falur nga Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë. Gjuha përkatëse e këtij ligji ligjit është si vijon:

1.2. Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës (Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 2003/25) dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:

1.2.8. Thirrja për rezistencë (neni 319) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit **edhe kryesit e këtyre veprave penale më poshtë të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:**

...

1.2.8.3. Shmangie nga tatimi (Neni 249); [theksi i shtuar]

Siç mund të vërehet nga gjuha e ligjit, vepra penale e shmangies nga tatimi falet vetëm nëse është kryer me qëllimin e kryerjes së veprës penale të 'thirrjes për rezistencë'. Në këtë lëndë as prokurori, as mbrojtja nuk pretenduan që vepra penale e shmangies nga tatimi u krye kinse me qëllimin e kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë. Prandaj, gjykata e hedh poshtë si të pabazuar këtë argument të mbrojtjes.

144.Më tej, nga raporti i AT-së duket se një shumë prej 20,689.65 eurosh është e papaguar për vitin 2012. Shuma prej 200,000.00 eurosh nuk iu raportua autoriteteve tatimore.

145.Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri ka vepruar në shkelje të nenit 63 (1), (2) (2.1), (3) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 2010 (TAP).

H) I pandehuri S.Sh.

146.Aktakuza e ngarkon të pandehurin S.Sh., me dy (2) akuza:

Akuza 1: Pranim i mallrave të vjedhura; dhe

Akuza 2: Shmangie nga tatimi

Akuza 1: Pranimi i mallrave të vjedhura

Pretendimi i prokurorit

147.Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri S.Sh., duke kryer kështu veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri S.Sh., është pronar i kompanisë R.I. Ai ka dijeni se kompania e tij R.I., pranoi 100,000 euro më 19 dhjetor 2011 dhe 100,000 euro të tjera më 23 dhjetor 2011. He tërhoqi rreth **37,000 euro para të vjedhura** dhe pranon se as ai, as i pandehuri I.F., nuk kishin autorizim për këto para. Ai pranon se ka përvetësuar **16,000 euro para të vjedhura** për veten e tij dhe pjesën tjetër ia dha të pandehurit I.F. Në llogarinë bankare të R.I., nuk kanë mbetur më para.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

148.Mbrojtja pretendon se vepra penale nuk ishte përshkruar në pajtim me ligjin. Krahas kësaj, në mënyrë të nënkuptuar mbrojtja pretendon se nuk ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale.

149.Më tej, mbrojtja pretendon se veprat penale u përfshinë në Ligjin Nr. 04/L-209 për Amnistinë.

Gjetja e gjykatës

150.Gjykata vëren se argumenti i mbrojtjes lidhur me përshkrimin e veprës penale është i pabazuar. Prokurori e ka përgatitur Aktakuzën në pajtim të plotë me Nenin 241 të KPPK-së. Peshat e secilit prej pretendimeve do të vendoset në një fazë të mëvonshme.

151.Gjykata vëren se nuk është kontestuar se i pandehuri S.Sh., është pronar i kompanisë R.I. Më tej nuk është kontestuar se kjo kompania mori shumën prej 100,000 eurosh nga kompania CE. Gjykata ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se këto para kanë buruar nga veprimtaria kriminale. I pandehuri tërhoqi personalisht shumën prej 37,000 eurosh. S.Sh, mori paratë që ai e dinte ose mund ta kishte ditur se ishin siguruar nga kryerja e një vepre penale

152.Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se ky i pandehur ka vepruar në shkelje të nenit 272 (1) dhe (2) të KPK-së së vitit 2003 (Neni 345 i KPK-së së vitit 2013).

Akuza 2: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

153.Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri S.Sh, duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

*I pandehuri S.Sh., si pronar i R.I., pranoi nga llogaria bankare CE e së pandehurës N.V., shumën e përgjithshme të 200,000 eurove para të vjedhura, dhe me dashje ai nuk veproi dhe nuk ia raportoi asnjëherë AT-së ndonjëherë prej këtyre të ardhurave të paligjshme, as pagoi ndonjëherë taksa për këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se R.I., ka përgjegjësi ligjore për **81, 447.22 euro** për shmangie nga tatimi për vitin fiskal 2011 dhe ka përgjegjësi ligjore për shumën e përgjithshme të **197,125.60 eurove** për vitet 2007-2013. Tatimi që i detyrohet për vitin 2012 është 29,708.14 euro.*

Më tej, përgjimi i telefonit të F.B., zbuloi një bisedë që ndodhi më 24 korrik 2013, në të cilën F.B., kontaktoi me N.Th., me telefon dhe u përgjigj S.Sh. F.B., pyeti “a mund të lëshosh një vërtetim sikur ke punuar tek unë?” S.Sh., i përgjigjet: “Ta shohim”. F.B., i thotë “hajde në zyrën time jam këtu bashkë me inspektorët e AT-së duke kontrolluar dokumentet”. Më vonë, në të njëjtën mbrëmje, N.Th., thërret F.B., dhe ata diskutojnë për lëshimin e faturave për një autolarje. Nga këto biseda është e qartë se të pandehurit F.B., N.Th., dhe S.Sh., po punojnë bashkë dhe po përpiqen të shmangin pagesën e tatimit.

Kundërshtimi i mbrojtjes

154.Mbrojtja pretendon se vepra penale e shmangies nga tatimi është falur nga Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë.

Gjetja e gjykatës

155.Gjykata nuk pajtohet me argumentin e mbrojtjes se vepra penale e shmangies nga tatimi është falur nga Ligji Nr. 04/L-209 për Amnistinë. Gjuha përkatëse e këtij ligji është si vijon:

1.2. Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës (Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 2003/25) dhe

Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, si më poshtë:

1.2.8. Thirrja për rezistencë (neni 319) përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në kryerjen e një vepre tjetër penale. Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit **edhe kryesit e këtyre veprave penale më poshtë të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë:**

...

1.2.8.3. Shmangie nga tatimi (Neni 249); [emphasis added]

Siç mund të vërehet nga gjuha e ligjit, vepra penale e shmangies nga tatimi falet vetëm nëse është kryer me qëllimin e kryerjes së veprës penale të 'thirrjes për rezistencë'. Në këtë lëndë as prokurori, as mbrojtja nuk pretenduan që vepra penale e shmangies nga tatimi u krye kinse me qëllimin e kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë. Prandaj gjykata e hedh poshtë si të pabazuar këtë argument të mbrojtjes.

I) I pandehuri H.Sh.

156. Aktakuza e ngarkon të pandehurin H.Sh., me një (1) akuzë:

Akuza 1: Shmangia nga tatimi

Pretendimi i prokurorit

157. Akuza pretendon se veprimet e mëposhtme u kryen nga i pandehuri H.Sh., duke kryer kështu veprën penale të shmangies nga tatimi. Teksti përkatës i Aktakuzës shprehet kështu:

H.Sh., është pronari i regjistruar i kompanisë P. E pandehura N.V., në bashkë-kryerje me F.B., dhe E.D., transferoi 200,000 euro para të vjedhura në

*llogarinë bankare të P., më 14 dhjetor 2011, për t'i investuar në një të ashtuquajtur "projekt për restorant." E.D., i tha H.Sh., se 200,000 euro po transferoheshin në llogarinë bankare të kompanisë Pirro të tij, por i pandehuri H.Sh., me dashje nuk veproi dhe nuk e raportoi asnjëherë ndonjërin prej këtyre të ardhurave të paligjshme tek Autoritetet e Administrimit të Tasave; as ai, as E.D., nuk i paguan AT-së ndonjë tatim lidhur me këto para të vjedhura. Një hetim i kryer nga AT tregon se P., kishte pasur një qarkullim të padeklaruar prej 200,000 eurosh për vitin 2011 dhe ka përgjegjësi ligjore për **44,831.54 eurot** në shmangie nga tatimi. AT rekomandon që H.Sh., të akuzohet për shmangie me dashje nga tatimi.*

Kundërshtimi i mbrojtjes

158.Mbrojtja pretendon se nuk ka prova të mjaftueshme për dyshim të mirë-bazuar në lidhje me këtë akuzë për të pandehurin H.Sh. Mbrojtja pretendon se klienti i saj ishte vetëm drejtor formal, ndërsa i pandehuri tjetër, E.D., ishte agjenti i regjistruar dhe sipas ligjit ai ka autoritet të plotë, njësoj si drejtor, në kompani. Sipas mbrojtjes, i pandehuri H.Sh., nuk menaxhonte financat e kompanisë dhe nuk u përfshi në ndonjë transaksion të kompanisë. Më tej, mbrojtja pretendon se i pandehuri nuk kishte qëllim t'i shmangej pagimit të tatimeve dhe se, në çdo rast, nuk ekziston detyrimi për t'ua raportuar Autoriteteve Tatimore paratë që pretendohet se ai i mori hua.

Gjetja e gjykatës

159.Gjykata vëren se nuk është kontestuar se i pandehuri H.Sh., është pronar i kompanisë P. Më tej, nuk është kontestuar se shuma prej 200,000.00 eurosh u transferua nga kompania CE në llogarinë bankare të P.,-s. Nuk është kontestuar se këto para nuk u raportuan tek autoritetet tatimore. Për të tepër, gjykata ka përcaktuar se ka dyshim të mirë-bazuar se qëllimi i transferimit të këtyre parave në llogarinë bankare të P., ishte për t'i pastruar ato dhe nuk ishte hua për P. Në këto rrethana, gjykata vlerëson se ka

dyshim të mirë-bazuar se P., ishte nën detyrimin që t'i raportonte këto të ardhura tek Autoritetet Tatimore.

160. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se ka dyshim të mirë-bazuar se i pandehuri veprim në shkelje të nenit 63 (1) dhe (4) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 2010 (TAP).

III. Kundërshtimet ndaj provave:

161. Vetëm mbrojtësi i të pandehurit J.B., ushtroi kërkesë për kundërshtimin e provave. Mbrojtja pretendon se provat "u siguruan në mënyrë të paligjshme nga policia, prokurori i shtetit, ose enti tjetër shtetëror".

162. Mbrojtja deklaron se në lidhje me Akuzën 1 të Aktakuzës, provat e siguruar përmes përgjimit ndërmjet J.B., dhe bashkëshortes së tij u siguruan dhe u përdorën si prova në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtën e respektit për korrespondencën private dhe familjare. Më tej, mbrojtja pretendon se këto prova janë jo relevante ose thelbësisht të pambështetshme dhe duhet të jenë të papranueshme.

163. Gjkata vëren se përgjimi i numrit telefonik që i përkiste të pandehurit J. B., u krye në bazë të një urdhri për përgjim, të nxjerrë me rregull nga Gjkata Themelore e Prishtinës më 2 prill 2013. Përgjimi i bisedës telefonike që ndodhi më 18 prill 2013 ndërmjet të pandehurit dhe bashkëshortes së tij u krye në pajtim me urdhrin e gjykatës.

164. Prandaj, gjykata arrin në përfundimin se provat u siguruan në pajtim me procedurat legal dhe, prandaj, janë prima facie prova të pranueshme. Pësia e provave në të cilat mbështeten palët do të vlerësohen në përfundim të kësaj procedure, kur gjykata të shqiptojë aktgjykimin.

III. Përfundim:

165. Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e mësipërme gjykata vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS,

PKR. Nr. 1046/13, 20 janar 2014

Gjyqtari Malcolm Simmons

Kryetar i trupi gjykues i EULEX-it

Mjet ligjor:

Në bazë të Nenit 250(4) të KPPK-së, palët e autorizuara mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi brenda (5) ditëve nga marrja në dorë e këtij vendimi me shkrim. Ankesa duhet, përmes kësaj Gjykate, t'i drejtohet Gjykatës së Apelit.